

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7355 E enjte 16 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Nuk është më sekret se Edi Rama ia ka dalë të zhgënjëjë edhe admiruesit e tij pa kushte, ata që i kanë mirëkuptuar mangësitë, duke i admiruar guximin, ...
Vijon në faqen 20

Nga MIMOZA KOÇIU

Spërdredhjet e një kryeministri



Opinion **i** Ditës

Padyshim që bisedimet e Kretës fundjavën e kaluar, ndërmjet ministrat të Europës dhe Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati me homologun ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Përtej Kretës



“Me këtë sistem drejtësie nuk hyni në BE”
Zv.ministri austriak: Tahiri? Askush nuk duhet të fshihet pas autoritetit

Nr. 2 i diplomacisë, Michael Linhart: Hapja e negociatave për anëtarësim, brenda 2018-ës
Nga ERI MURATI
Për herë të parë në programin e një qeverie shqiptare, Austria është renditur si partner strategjik. Krahas Italisë, Greqisë dhe Turqisë, në programin e “Rama 2”, marrëdhëniet me Vjenën ...
Në faqen 6

ZBARDHEN VETEDEKLARIMET E 15 TOGAVE TE ZEZA NE GJYKATEN E LARTE DHE KUSHTETUESE

PASURITE E GJYQTAREVE, KUSH ESHTË ME I KAMURË

Shënjestrat e vetingut në drejtësi, me disnivel të ardhurash vjetore. Nga Guxim Zenelaj tek Ariana Fullani, Bashkim Dede, si renditen



(Në foto) Gjykatës (foto ilustruese)

TAKIMI ME BUSHATIN
Mblidhet Këshilli i Stabilizimit me BE: Mogerini: Kushti kryesor, reforma në drejtësi
Në faqen 3

DOSSIER
Letrat e panjohura të Mustafa Krujës: Si ta shpëtoj nderin nga fundi i qeverisë
Në faqen 14-15

AMENDAMENTET
Buxheti, LSI: Të ulet në 5% TVSH për ushqimet e shportës
Në faqen 5

TITUJT E RINJ
Panairi i librit nis me “protestë”, botuesit përplasen me ministrinë
Në faqen 17

POLICIA JEP DETAJET, ENRAT E PERFITUESVE



Abuzimi me pronat në Spille, si fitoi Elvis Roshi, Fatos Kaja e gjyqtari Lusha
Në faqen 7

Policia: Pjesë e një grupi kriminal, akuzohen edhe për rrëmbim personi
Arrestohen 3 vetë në Fier për drogë e vrasje
Kujtim Kuçi, Bashkim Ahmeto dhe Dritan Tusha lëviznin me makina të blinduara

Operacioni “Forca e ligjit” ka nisur nga Fieri. Tre persona, pjesë e një grupi kriminal që akuzohen për trafik droge, vrasje e rrëmbime kanë përfunduar në pranga. Bëhet fjalë për 45-vjeçarën Kujtim Kuçi dhe 43-vjeçarën Bashkim Ahmeto nga fshati Sulaj i Fierit



dhe 47-vjeçarën nga Shijaku, Dritan Tusha, 47 vjeç. Mësohet se personat në fjalë u arrestuan në momentin që ndodheshin në ambientet e një bar-kafe në fshatin Fermë Çlirim, ndërsa nuk kanë bërë rezistencë. Lajmi është bërë me dije nga drejtori ...
Në faqen 10-11

REFORMAT SIGURIA

"Peshqit e mëdhenj", ambasadori i SHBA diskuton me kreun e qeverisë

Doland Lu në zyrën e Ramës, para mbledhjes së qeverisë



Ambasadori amerikan Doland Lu, dje me kryeministrin Edi Rama

Ambasadori amerikan Doland Lu është parë dje, të shkojë në zyrën e kryeministrin Edi Rama. Takimi u zhvillua në mesditë, ndërkohë që kryeministri kishte thirrur në pas edhe mbledhjen e qeverisë. Asgjë zyrtare nuk doli nga takimi, por mendohet se mes tyre është diskutuar në lidhje me reformën në drejtësi, por edhe për çështje të politikës së ditës në Shqipëri. Pak ditë më parë, gjatë një aktiviteti ambasadori amerikan Donald Lu deklaroi se në fillim të vitit që vjen ai pret që të kapen edhe peshqit e mëdhenj. Ndërsa prezantoi edhe dy ekspertët e FBI-së në një aktivitet ku u lanca edhe operacioni "Forca e Ligjit", Lu tha: "Partnerët ndërko-

mbëtarë të Shqipërisë e presin këtë, populli shqiptar e meriton këtë. Së fundmi ju keni një fjalë në shqip që dieli duket që në mëngjes. Ky plan veprimi tregon se krimi

i organizuar shqiptar është problem serioz dhe kërcënim për sigurinë kombëtare. Ai tregon se organet e drejtësisë kanë dështuar kundër grupeve kriminale dhe Shqipëria

ka një problem me lidhjen mes grupeve kriminale dhe politikanëve. Kujtoni rastet e Ndokës, Frrokut, Elvis Rroshit, Gentian Muhametit... Ky problem ka një kosto për politikën shqiptare që nga rënia e komunizmit". "SHBA presin që të luftohet kundër krimit të organizuar, pavarësisht lidhjeve me politikanë të fuqishëm. Asnjë nuk është i paprekshëm. Në gjuhën shqipe "peshku i madh e ha të voglin", për një herë të vetme në Shqipëri le të hamë peshkun e madh- ka thënë Lu.



Shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, Mogherini dhe ministri Ditmir Bushati

Kryeministri, në Konferencën për sfidat e sigurisë: pastrimi i radhëve të policisë parakusht i padiskutueshëm"

Edi Rama: Reformat, rrugëtim i vështirë

"Kush thotë se nuk jemi në rrugën e duhur, s'do të shohë"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se vendi është në rrugën e duhur sa i përket integritetit. Duke shpërndarë deklaratën e Këshillit të Stabilizimit dhe Asociimit, në rrjetin social, Ram u shpreh dje: "Reformat nuk janë shëtitje, po rrugëtime të vështira. Të bësh shetë është e lehtë ta thuash, po duhen përpjekje të jashtëzakonshme ta bësh. Por sot, kush thotë se nuk jemi në rrugën e duhur, ose nuk do të shohë ose gabimisht e ka menduar të lehtë këtë rrugë. Kënaqësi të ndaj me ju këndvështrimin e Bashkimit Europian mbi aktualitetin e përpjekjes sonë". Ndërkohë më herët dje, kryeministri Rama mori pjesë në Konferencën e 2-të shkencore ndërkombe të "Shkencave ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë", ku foli për vettingun në polici dhe reformën në fushën e sigurisë. "Në kuadrin e një sërë reformash rrënjësore që qeveria ka ndërmarë pas pothuajse tre dekadash stancjacioni dhe lehtëgjie, në raport me mekanizmat dhe funksionet e shtetit, reforma në fushën e sigurisë është padyshim një nga më të rëndësishmet. Shteti modern ka një katalog të



Kryeministri Edi Rama dje në "Shkencë ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë"

madh përgjegjësish dhe detyrash për të plotësuar përballë qytetarëve të tij. Pikërisht në funksion të sigurisë dhe në varësi të qasjeve dhe shkollave politike, spektri i përgjegjësisë që shteti tenton të plotësojë, ndryshon. Në disa qasje, shteti mban pak dhe në disa të tjerë shumë më tepër rol dhe përgjegjësi", u shpreh Rama. "Reformat tona në siguri synojnë një strategji të re dhe të pandarë të shtetit në këtë fushë", tha më tej Kryeministri. Sipas tij, "pastërtia e radhëve të Policisë dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese, integriteti i lartë i punonjësve të këtyre institucioneve është para-

kusht i domosdoshëm dhe i padiskutueshëm. Ne kemi bërë sa kemi mundur, jo sa kemi dashur, në funksion të rritjes së shpërbërimit moral dhe financiar për punonjësit e Policisë së Shtetit, do vazhdojmë të bëjmë edhe më shumë, por procesi historik i pastrimit të Policisë së Shtetit. Ashtu sikundër dhe pastrimi i sistemit gjyqësor nga elementë të kriminalizuar, të korruptuar, apo thjesht të paafetë për plotësimin e detyrës do të vijojë me vendosmëri dhe ekzigjencë të shtuar së pari në radhët e Policisë së Shtetit e pastaj të të gjitha strukturave të tjera ligjzbatuese". "Jam i bindur

OPERACIONI
Duke iu rikthyer operacionit "Forca e ligjit", e cila sipas tij, "do të synojë katet më të larta dhe nyjet më të thella të krimit të organizuar", Rama tha se "në këtë operacion më rëndësi është shenjestrimi i aseteve dhe i financave me origjinë kriminale, duke i zhveshur këto rrjete dhe këta elementë nga mundësia e rikthimit".

që procesi i Vetting-ut që është organizuar dhe që do të fillojë të zbatohet në Policinë e Shtetit, duke filluar nga muaji janar, do të japë rezultate të qenësishme, ashtu sikundër kam shumë besim se brezat që do të dalin prej Akademisë, duke filluar nga së shpejti dhe në vijim vit pas viti, do të jenë një burim i jashtëzakonshëm transformimi dhe transfuzionit të gjakut të Policisë së Shtetit", tha më tej, Rama. Po ashtu shtoi Kryeministri "vijmi i goditjeve për të shkatërruar grupet e rrjetet kriminale mbetet një prioritet kryesor operacional për Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese".



Baqiraj, iku nga Akademia, kandidon për bordin e krimeve të komunizmit

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, zhvilloi dje, një seancë dëgjimore me kandidatët e propozuar nga Akademia e Shkencave dhe shoqëria civile për anëtarët e Bordit të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Nga propozimet e ardhura nga Akademia e Shkencave morën pjesë në dëgjuesë ish-kryetari i Akademisë Gudar Baqiraj dhe z. Vasil Tole. Ndërsa, nga propozimet e bëra nga shoqëria civile morën pjesë në seancë dëgjimore znj. Valjeta Kaftalli, znj. Jonila Godole, z. Simon Mirakaj, z. Nebil Çika dhe z. Agron Hadri. Akademia e Shkencave dhe shoqëria civile përfaqësohen përkatësisht me nga 1 anëtar nga 7 që është përbërja e Bordit të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Deputetët e komisionit, pasi u njohën me prezantimin e jetëshkrimeve, diskutuan dhe shtruan pyetje mbi vizionin dhe platformat e secilit prej kandidatëve. Përveç Akademisë së Shkencave dhe shoqërisë civile, subjekte propozuese për anëtarët e tjerë të Bordit janë Instituti i Integritetit të ish-të Përndjekurve Politik dhe Konferenca e Rektorëve, seancat dëgjimore të të cilave do të zhvillohen në një nga mbledhjet e ardhshme të komisionit.



Mblidhet Këshilli i stabilizimit me BE: Shqipëria ka bërë progres, kyçe reforma në drejtësi

'Tahiri', Mogherini: S'komentoj hetimet dhe punën e gjyqësorit

Bushati: Presim që 2018-ta të jetë vit vendimtar për negociatat

Darina Tanushi

Këshilli i Stabilizimit dhe Asociimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, i cili u mbajt dje në Bruksel vlerësoi progresin e Shqipërisë. Këshilli i SA-së vuri në dukje raportin e Komisionit për Shqipërinë për vitin 2016, ku njihet fakti që vendi ka bërë progres të mëtijshëm drejt përmbyshjes së kriterëve politike për anëtarësim dhe se përgjithësisht, ka vazhduar progresin e qëndrueshëm për pesë përparësitë kryesore për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Këshilli i SA-së vuri gjithashtu në dukje se komunikimi i komisionit për vitin 2016 mbi politikën e zgjerimit të BE-së, duke pasur parasysh progresin në përmbyshjen e prioritetëve kyçe dhe në varësi të progresit të besueshëm dhe të prekshëm në zbatimin e reformës në drejtësi, në veçanti rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetingut), rekomandoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Që atëherë, Shqipëria ka bërë progres të madh shtesë. Këshilli i SA-së vuri në dukje angazhimin e vazhdueshëm të Shqipërisë ndaj agjendës së reformave. Me këtë rast, këshilli theksoi se së bashku me përparësitë e tjera kyçe, reforma gjyqësore mbetet thelbësore në procesin e pranimit të Shqipërisë në BE dhe mund të jetë transformuese për reforma të tjera. Në këtë kontekst, BE-ja përsëriti emërimin e institucioneve të verifikimit në qershor 2017.



qershorit 2017. **ÇËSHITJA 'TAHIRI'**
Në konferencën e përbashkët për mediat, shefja e lartë e BE-së, Federica Mogherini u pyet edhe për çështjen "Tahiri". "Është rregull im i artë që kurrë të mos komentoj për hetimet në vazhdim dhe punën gjyqësore. Mendoj se asnjë institucion nuk është i saktë për të komentuar hetimet në vazhdim apo punën e gjyqtarëve, jo në vendin tim, jo në vendet e Bashkimit Evropian, jo në vendet partnere dhe mlike. Unë e respektoj dhe admiroj punën e gjyqësorit shumë, për ta vënë atë në qendër të komentit politik të një institucioni tjetër", tha Mogherini, duke u rezervuar të përgjigjet. "Por - shtoi ajo - mund të them se trafikimi dhe kultivimi i drogës është një prioritet kyç për BE-në, është një prioritet i përbashkët me autoritetet shqiptare dhe ky është një nga elementet kyçe edhe për rrugën na pret. Ajo që unë mund të them është se e shoh vendosmërinë, e shoh edhe duke konsideruar bashkëpunimin e përmendur të agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit për të bërë përpara. Natyrisht, ne duhet të shohim rezultate të qarta. E them këtë jo sepse ky është një kusht i BE-së, ky është një kusht i popullit shqiptar", shtoi shefja e Politikës së Jashtme të BE-së. Ndërsa nga ana e tij, ministri i Jashtëm, Bushati tha: "Përgjigja që ka ardhur nga Parlamenti i Shqipërisë, nga mazhoranca, ka qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe pa asnjë ekuivok. I jemi përgjigjur kërkesës së Prokurorisë shqiptare dhe Prokurorisë së Katania për të filluar hetimin ndaj ish-ministrit të Brendshëm, aktualisht deputet në Parlamentin e Shqipërisë. Parlamenti shqiptar ka vendosur për t'i hequr imunitetin, çka i ka krijuar të gjitha mundësitë prokurorisë për të marrë nën hetim ish-ministrit, për të bërë kontroll në banesën e tij, për të pasur mundësi për ta vënë nën përgjim 24 orë, për të mos i krijuar asnjë lloj mundësie për të lëvizur jashtë territorit shqiptar dhe për të qenë në dispozicion të hetimeve 24 orë. Të kemi durim, kemi hapur një kapitull shumë të rëndësishëm për procesin e shtet-konsolidimit demokratik në Shqipëri. Prokuroria dhe gjyqësori nuk do të jenë një levë e qeverisë apo politikës si në të shkuarën, por do të thonë fjalën e tyre deri në fund", theksoi Bushati.

Bregu: Duhet të hapen negociatat me BE, opozita vërtitet si mullinjte e erës

Ish-ministria e Integritimit, Majlinda Bregu, i bëri dje thirrje politikës shqiptare që të kapë mundësinë për të bërë të mundur hapjen e negociatave me BE-në në 2018. "Pse Mogherini tha që 2018 është vit unik për Shqipërinë dhe rajonin? Ballkani Perëndimor nuk mund të qëndrojë përgjithmonë në listë pritjeje për anëtarësim, për më tepër kur askush nuk di të thotë veç spekulatorëve, se kur do të ndodhë kjo. Integritimi evropian nuk duhet të jetë skaji i fundëm në debatin për të ardhmen e Europës. Do të ishte përgjegjësi e rëndë sot dhe mëkat historik nesër, nëse procesi i anëtarësimit të vendeve tona do të shihet me sytë e zbehtë të bezdisë së tepërt, siç shohim dikë që na lutet", shkroi Bregu në një status në "Facebook". Sipas saj, "rajonin dhe Shqipëria kanë nevojë të dëshpëruar për shpresë e shtet ligjor. Është jetike për një vend si Shqipëria ku opozita vërtitet si mullinjte e erës, media kontrollohet e të vërtetën e takson si mall luksi, shoqëria civile mblidhet kruspull nga mospërfillja, drejtësia gulçon ngase është e pabesueshme, që negociatat për anëtarësim të çelen mbi bazën e një premisë të qartë: është i vetmi proces që do ketë lupën më të madhe se tepsia e zullumeve. Po iku dhe ky shans, të na rrojë tepsia, timoni, buzagazet e gjëra dhe të trasha në fytyrat-maskë dhe hajt të mblidhemi të gjithë e të bëjmë fletërrufe si njerëz të panxënë se pse Europa reagon për krimet me vonesë dhe pse portat e së ardhmes hapen vetëm kraja Serbisë e Malit të Zi!", u shpreh Bregu.



like dhe mirëpriti në veçanti konsolidimin e masave që synojnë forcimin e transparencës dhe meritokracinë e shërbimit civil, si dhe përmirësimin e efektivitetit në ofrimin e shërbimeve. Këshilli i SA-së njohu rolin e Shqipërisë në rajonin si një partner ne-pro-aktive dhe konstruktive. "Ne ramë dakord dhe ndamë mendimin se viti 2018 do të ofrojë një mundësi unike", tha në konferencën e përbashkët për mediat, shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, Mogherini. Ndërsa, ministri Dimitir Bushati u

DEKLARATA

Këshilli theksoi se së bashku me përparësitë e tjera kyçe, reforma gjyqësore mbetet thelbësore në procesin e pranimit të Shqipërisë në BE dhe mund të jetë transformuese për reforma të tjera. Në këtë kontekst, BE-ja përsëriti emërimin e institucioneve të verifikimit në qershor 2017.



Bahri Shaqiri

Vendimi, pak ditë pas dorëheqjes së Ajazit

Meta emëron këshilltar për sigurinë ish-kreun e SHISH-it, Bahri Shaqiri

Ish-kreu i SHISH, Bahri Shaqiri u emërua dje këshilltar i Presidentit Ilir Meta për sigurinë. Pas lënies së detyrës në krye të SHISH-it, Shaqiri ka mbajtur postin e zv.ministrit të Infrastrukturës në qeverinë "Rama-Meta". Së fundmi ai ishte përfshirë në radhët e LSI-së. Po ashtu, ai ishte edhe në listat e kandidatëve për deputetë të kësaj partie. Vendimi për emërimin e Shaqirit në këtë detyrë nga presidenti vjen pak ditë pasi kryeministri Edi Rama propozoi një tjetër ish-drejtes SHISH-i, Visho Ajazi Likën si ambasador i Shqipërisë pranë NATO-s. Ndërsa kryeministri Edi Rama e propozoi si ambasador në NATO ish-kreun e SHISH, Visho Ajazi, Presidenti Ilir Meta ka marrë si këshilltar për sigurinë një tjetër ish-kryetar të Shërbimit Informativ Shtetëror. Është fjala për Bahri Shaqirin. Para emërimit të tij si këshilltar i presidentit, Shaqiri ka mbajtur postin e zëvendësministrit të Transporteve dhe Infrastrukturës, prej muajit shkurt 2016. Shaqiri ka shërbyer pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në postin e këshilltarit të ministrit të Mbrojtjes, në periudhën 2014-2015. Shaqiri ka mbajtur postin e drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH) për një periudhë rreth tetëvjeçare, prej viti 2005 deri në vitin 2012. Karrierën e tij në SHISH e ka nisur në vitin 2002, si shef i Kabinetit të Drejtorit të SHISH, dhe njëherazi përgjegjës për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

SHKARKIMI DEBATI

Valentina Madani


KQZ nxjerr një tjetër provë që rrezon pre fëndimet e PS-së për heqjen e mandatit të kryebashkiakut të Mallakastrës, Agron Kapllanajt për shkak të ligjit të dekriminalizimit. Për dënimin e Kapllanajt ka pasur dijeni edhe ish-kreu i KQZ-së, Denar Biba, i cili në një deklaratë të datës 19.02.2017 u shpreh se z. Kapllanaj me disa funksionarë të tjerë kishte shënuar në formular, por që nuk ishte në kushtet e heqjes së mandatit. Më datë 19.02.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dalë në një komunikim publik, ku ka sqaruar se ishin 18 funksionarët të lartë, pjesa më e madhe të të cilëve deputetë, që kishin deklaruar dënime në formularë e tyre të dekriminalizimit. Në atë periudhë debati ishte fokusuar në heqjen e mandatit të kryetarit të Bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshi dhe atij të Fushë-Krujës, Artur Bushi. Sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme, Kapllanaj ishte rehabilituar në vitin 2016 dhe për këtë arsye nuk duhej t'i hiqej mandate. Por, në mbledhjen e KQZ-së ku u shqyrtua çështja, nënkryetari i KQZ, Biba tha se mandati i Kapllanajt duhet të ishte hequr në vitin 2016, ndërkohë që shkresat e publikuara nga KQZ tregojnë se Prokuroria e Përgjithshme me shkresën e datës 21.02.2017 ka kërkuar t'i vihen në dispozicion formularët e vetedeklarimit të 30 subjekteve të përmendura në deklaratën e zëdhënësës së KQZ-së në datën 19 shkurt. Vetëm një ditë më pas, kryetari i KQZ-së në atë kohë, Denar Biba i ka kthyer përgjigje prokurorisë me shkresën e datës 22.02.2017, me numër protokoll 1218/1, ku i thotë se: "... KQZ ka konstatuar me bindje të plotë se dhënat e deklaruara të funksionarëve publikë, sipas deklaratës për shtyp të datës 19.02.2017, nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015. Në vlerësim të KQZ të dhënat e disponuara nuk përbënin shkak për verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme".

REAGIMI
KQZ hodhi poshtë dje pretendimin e PS-së për falsifikimin e vendimit të KQZ-së për çështjen "Kapllanaj". Zëdhënësja e Komisionit, Drilona Hoxhaj shprehet: "Kryetari i KQZ-së nuk ka detyrë, nuk drejton zbardhjen e akteve të KQZ-së, pasi detyra e administratës është proces tërësisht teknik dhe refleksion besnikërisht debatin dhe qëndrimet e shprehura dhe të dokumentuara në mbledhjen e KQZ-së". "Dje (pardje) media e in-

Komisioni, tjetër provë kundër, PS për dënimin e Kapllanajt kishte dijeni ish-kreu i KQZ

Zbardhet letra, KQZ e Denar Bibës: Kapllanajn nuk e prek dekriminalizimi

Hoxhaj: Akti që nuk ekziston, s'falsifikohet dot



REAGIMI
"Ky veprim i shumicës së anëtarëve të KQZ-së, totalisht në kundërligjshmëri, përveçse përbën shkak për përgjegjësi penale, na forcon edhe më shumë bindjen për kërkesën e drejtuar kryetarit të Kuvendit për shkarkimin e kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri", tha deputetja e PS-së.


KQZ, Biba: Shumica në paligjshmëri, vendimi u falsifikua

Partia Socialiste pretendon se ka një provë të re që konfirmon se kryetari i KQZ-së, Klement Zguri meriton shkarkimin. Deputetja Klotilda Ferhati deklaroi se Zguri ka falsifikuar materialet e mbledhjes të këtij komisioni, duke përforcuar bindjen e shumicës se ai duhet shkarkuar. Rasti është denoncuar nga nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba në rrjetet sociale. "Ky vendim është krejtësisht falsifikim i rrethanave të mbledhjes së datës 03.11.2017. Ky vendim nuk është marrë kurrë në një mbledhje publike, apo sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Gjithkush mund të bindet lehtë duke parë regjistrimin e mbledhjes. Me këto veprime, shumica e KQZ-së po shkon nga paligjshmëria në paligjshmëri!", shprehet Denar Biba në "Facebook". Më herët Biba tha: "Projektvendimi që na u sol për firmë është i firmosur nga 3 anëtarë dhe kryetari i KQZ. Projektvendimi paraqet rrethana dhe vendimarrje që nuk kanë ndodhur, nuk janë marrë apo votuar në ndonjë mbledhje të KQZ, ndaj edhe u denoncua sot (dje) publikisht si akt që tenton të falsifikojë vendimarrjen e datës 03.11.2017. Por, për fat mbledhjet e KQZ-së janë të regjistruara dhe me zë e figurë del qartë se cili ishte rezultati i vërtetë i mbledhjes së datës 03.11.2017.



Mandati i Kapllanajt, Ferhati: KQZ shkeli ligjin, kemi prova

Deputetja PS-së, Klotilda Ferhati, akuzoi dje se KQZ-ja ka shkelur të gjitha rregulloret në lidhje me drejtuesin e Bashkisë së Mallakastrës, Agron Kapllanaj për të mos i hequr mandatit, pasi kishte probleme me dekriminalizimin, pasi sipas saj, ai rezultoi të jetë me probleme. "Kujtojmë se ajo mbledhje u thirr me kërkesë të dy anëtarëve Denar Biba e Bledar Skënderi, me propozimin që KQZ-ja të merrte në shqyrtim e të vendoste shpalljen e pavlefshme dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Mallakastrë, z. Agron Kapllanaj", pasi në çastin e marrjes së mandatit, Agron Kapllanaj gjendej në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji për dekriminalizimin si i dënuar për vjedhje, theksoi ajo. Ferhati tha se ka prova me audio dhe video që në datën 3 nëntor 2017 është marrë vendimi për të mos u hequr mandatet respektive, duke shkelur rregulloret dhe ligjet. Sipas saj, kërkesa e mazhorancës për të kërkuar shkarkimin e kreut të KQZ-së, Klement Zguri është plotësisht e drejtë, pasi ai nuk dolet përtej të shkuarës së tij partiake. Ajo tha se ky veprim nga ana e KQZ-së është një paligjshmëri totale, e cila plotëson kushtet për t'u trajtuar si veprë penale.



PS, Balla: Zguri po 'zhytet' në Ilumin Basha-Kryemadhi

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla në një status në "Facebook" deklaroi dje se kryetari i KQZ, Zguri po "zhytet" më thellë në përpjekjen për të shpëtuar kryebashkiakun e Mallakastrës, Agron Kapllanajn. Balla akuzoi kreun e KQZ-së se në përpjekjen për të shpëtuar kryebashkiakun, sipas tij të prekur nga dekriminalizimi, Zguri po dëmtton veten e tij. "Kryetari i KQZ, Klement Zguri 'zhytet' edhe më thellë në Ilumin e stisur nga Basha&Kryemadhi për të shpëtuar kryetarin e Bashkisë Mallakastrë, Agron Kapllanajn nga zbatimi i ligjit të dekriminalizimit. Veprë penale, përpjekja e sotme e Zgurit për të falsifikuar vendimin e KQZ-së. Pak më vonë bëhen publike provat", deklaroi kreu i deputetëve të PS-së, Taulant Balla.

NJOFTIM PER SHITJE

Ne Zyren e Permbaresit Gjyqesor Arjan Palla me adrese Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi, H-2.K-3, Ap.-5-Tirane me dt. 20.11.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise me nr. 1/197 +3-26, vol8, fq.48, zK 8260, lloji i pasurise apartament me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane, rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa. Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 28405,2 Euro.

teruesar shqiptare zbuloi të vërtetën rreth akuzës publike të përhapur nga zyra e grupit parlamentar të Partisë Socialiste për gjoja 'fshihen' e praktikës 'Kapllanaj' nga ana e kryetarit të KQZ-së, duke bërë një verifikim të thjeshtë në zyrën e protokollit të KQZ-së. Verifikimi me protokollin e administratës sonë provoi se praktika në fjalë është përcjellë nga kryetari për veprim në kohë rekord. Akuzat për 'fshenje' u provua dje se ishte furtunë në gotë. Sot në 'gotën' e KQZ-së shpërtheu

'furtuna' e radhës, akuzat për falsifikim të vendimit të KQZ-së për çështjen 'Kapllanaj', përsëri nga ana e kryetarit", tha znj.Hoxhaj. Ajo sqaroi më tej: "1. kryetari i KQZ-së nuk ka detyrë, nuk kryen, nuk merr pjesë dhe nuk drejton zbardhjen e akteve të KQZ-së. Zbardhja e akteve është detyrë e administratës, është proces tërësisht teknik dhe refleksion besnikërisht debatin dhe qëndrimet e shprehura dhe të dokumentuara në mbledhjen e KQZ-së. 2. deri në momentin e kësaj dek-

larate nuk ka ende vendim të zbardhur për çështjen në fjalë. Akti që nuk ekziston, nuk falsifikohet dot. Edhe kjo është një e vërtetë e thjeshtë për t'u kujtuar. 3. Lidhur me draft-vendimin ka debat midis anëtarëve përsa i përket përmbytjes, sepse anëtarët nisimtarë kërkojnë që vendimi të reflektojë vetëm arsyetimin e tyre dhe votën kundër të shumicës, kurse një pjesë e anëtarëve që kanë votuar kundër, kërkojnë që vendimi të reflektojë arsyetimin e shumicës. Ky është debat i brendshëm banal, i cili sa herë

ndodh, zgjidhet me qetësi dhe në frymë bashkëpunimi. Për fat të keq, qetësia dhe fryma e bashkëpunimit kanë marrë arratinë që ditën që KQZ-në e hodhën në syrin e ciklonit politik".



Hidhen shortet e para për vettingun, gati formulari i denoncimit nga publiku

Formulari, si mund t'i denoncojnë qytetarët, gjyqtarët e korrumpuar

"Prova dhe fakte për abuzimin me detyrën"

Valentina Madani

Komisioni i pavarur i kualifikimit i është drejtuar dhe opinionit publik që të japë mbështetje me denoncime, duke paraqitur fakte dhe prova ndaj atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë abuzuar me detyrën, ose janë përfshirë në korrupsion. Për këtë qëllim, komisioni publiko edhe një formular nëpërmjet të cilit synohet përfshirja edhe e qytetarëve në këtë proces shumë të rëndësishëm për vendin. Formulari është i organizuar në bazë të tri kriterëve, që përdoren për rivlerësim: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësisë profesionale. Ndërkohë, pak ditë më parë procesi i vettingut filloi te Krimet e Rënda e Gjykata Kushtetuese, ku në fildër ishin dhjetë dosjet e dy gjyqtarëve, si dhe te Gjykata e Tiranës, ku do kalonin për verifikim gjashtë gjyqtarë.

PROCESI

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) filloi dje procesin e vettingut për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë, duke realizuar shortet e para në lidhje me listën e subjekteve prioritare, sipas parashikimeve të ligjit. Sipas njoftimit për shtyp të KPK-së, ky komision ka përgatitur formularin e denoncimit nga publiku, me qëllim informimin nga publiku me anë të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit. "Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve ose rrethanave, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit është detyrim jo vetëm ligjor, por edhe moral e qytetar", theksohet në njoftim. Nëpërmjet kësaj deklarate për shtyp, komisioni synon të prezantojë "Formularin e denoncimit nga publiku", me qëllim përfshirjen e opinionit në këtë proces të rëndësishëm për vendin. Formulari është i or-



Faksimile e KOZ për kreun e bashkisë së Mallakastres



PROVAT

"Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve ose rrethanave, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit është detyrim jo vetëm ligjor, por edhe moral e qytetar", thuhet në njoftimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.



Ilir Z

Berisha: Pse mbeti jashtë kabinetit Kodheli

Berisha: Doganierët kalojnë kamionin kontrabandë

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, që pretendon se di arsyen se përse ish-ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli mbeti jashtë kabinetit "Rama 2". Sipas qytetarit në fjalë ka qenë vetë Kodheli, që i ka zbuluar arsyet. "Një burim shumë i afërt me ish-ministren e Mbrojtjes, Kodheli më tha dje se sipas saj, Rama e la atë jashtë kabinetit për dy arsye. Së pari, Mimi thotë se Rama u bë xheloz shumë për marrëdhëniet e saj me amerikanët. Një delegacion i senatit amerikan i kishte folur Ramës në prani të saj me superlativa për Mimin, por jo për Ramën. Së dyti, Mimi i thotë këtij burimi 100% të besueshëm se Rama i kishte kërkuar t'i bënte një afërë si ato të Beqes dhe gjasme kjo nuk kishte pranuar", thuhet në mesazhin dërguar Berishës. Po dje ish-kryeministri publikoi mesazhin e një qytetari dixhital, i cili thotë se pas kalimit të mallrave kontrabandë me kamion në pikën kufitare të Qafë-Bohtës, 2 doganierët dhe 2 shoferët janë arratisur në drejtim të Greqisë. Sipas qytetarit dixhital, personi kryesor në këtë kontrabandë mallrash është përgjegjësi i turnit, Endri Dafa.

Buxheti, Kryemadhi: Favorizon të pasurit, rrënon të varfrit

Propozimi i LSI për buxhetin, të ulët në 5% TVSH për ushqimet e shportës!

Lëvizja Socialiste për Integrimin propozon që në buxhetin e vitit 2018, TVSH për ushqimet dhe shportës të ulët nga 20 në 5%. Një tjetër propozim ka të bëjë me TVSH për biznesin, për të cilin LSI kërkon që pragu përjashtues për biznesin e vogël për skemën e TVSH të mbetet në nivelin 5 milionë lekë të reja, jo të ulët në 2 milionë siç ka propozuar qeveria. Gjithashtu, LSI propozon që taksa e banesës së parë të jetë zero, për banesën e dytë dhe më shumë të mbetet propozimi i qeverisë. Një tjetër propozim ka të bëjë me TVSH për biznesin, për të cilin LSI kërkon që pragu përjashtues për biznesin e vogël për skemën e TVSH të mbetet në nivelin 5 milionë lekë të reja, jo të ulët në 2 milionë siç ka propozuar



qeveria. LSI organizoi dje një tryezë diskutimi në lidhje me buxhetin dhe paketën fiskale. Gjatë fjalës së saj në këtë tryezë, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi tha se mazhoranca aktuale nuk ka një program qever-

isës apo plan ekonomik për të luftuar varfërinë dhe për të ngushtuar hendekun midis të pasurëve dhe të varfërve. "Kjo mazhorancë nuk ka një program qeverisës apo një plan ekonomik për të luftuar varfërinë dhe për të ngushtuar hendekun midis të pasurëve dhe të varfërve, por themi që kjo qeveri ka një politikë për të stimuluar oligarkët dhe klientët e qeverisë së vet. Nuk ka politika ekonomike për të stimuluar punësimin, prodhimin vendës dhe eksportet shqiptare. Buxheti 2018 tashmë është mëse e qartë për të gjithë, që rrit taksat për 99% të shqiptarëve, të cilët janë të varfër dhe të klasës së mesme dhe ul taksat për 1% të bizneseve dhe oligarkëve që janë pjesë e qeverisë", tha Kryemadhi.

ganizuar në bazë të tri kriterëve, që përdoren për rivlerësim, pasurim kontrolli të figurës, si dhe vlerësimi i aftësisë profesionale. Është mjaft e rëndësishme të kuptohet se misioni i KPK nuk është të rishikojë vendimet e gjykatave, por të mbledhë të dhëna lidhur me veprimet

korruptive të tyre, që kanë ndikuar në vendimmarrje, nënvizohet në njoftim. Ky formular gjendet 'online' në faqen zyrtare të institucionit www.kpk.al, si dhe mund të plotësohet me ndihmën e një punonjësi të KPK-së, në mjediset e këtij institucioni. "Komisioni i pavarur i kual-

ifikimit inkurajon ndërëgjen qytetare që çdo informacion të vlefshëm që mund të keni, fotografi, dokumente, të dhëna të tjera t'i ndani me komisionin e pavarur të kualifikimit dhe të kontribuoni në këtë proces jetik për vendin", përfundon njoftimi i KPK-së.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NUJFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1- "Ara-Truall" me sip. totale, 562 m², nga kjo truall 112,2 m², dhe ndihetesi 112,2 m², Nr Pasurisë 61/241, ZK: 1298, Volum.17, Faqe.87, e ndodhur në Bucinas, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **110.800 Euro**. Ankandi zhvillohet datë 11.12.2017 ora 16.00 në adresën Rr."1, Qemali", Pall. "Fratar", K.6,Tirane.

2- "Truall" me sip. totale, 3.942 m², Nr Pasurisë 731/145, Zona Kadastrale: 2648, Volum.7, Faqe.110, e ndodhur në Memelisht, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tiranë Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **58.602 Euro**. Ankandi zhvillohet datë 11.12.2017 ora 16.00 në adresën Rr."1, Qemali", Pall. "Fratar", K.6,Tirane

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tirane, Njësia 10 njofton se me date 01.12.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 61,5 m², me numër pasurie 50/1994-1, volumi 20, faqe 164, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Miri Adil Ruga dhe Zy. Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 12.390 (Dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 56,5 m², me numër pasurie 50/1994-1, volumi 20, faqe 163, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Miri Adil Ruga dhe Zy. Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 11.391 (Njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672072580 , email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tirane, Njësia 10 njofton se me date 28.11.2017 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i I për shitjen e pasurisë të paluajtshme Apartament me sipërfaqe totale 65 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tirane me Nr pasurie 1/154+1-4, Vol.7, Fq.247, ZK.8350 në pronësi të Z.Lirim Petref Koçaj , Petref Hito Koçaj, Fato Mejdo Koçaj, Altin Petref Koçaj, Agron Petref Koçaj dhe Eteva Xheladin Koçaj me vlerë fillestare në ankand 39.000 (Tridhjetë e nëntë mijë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672072580 , email enuar.merko@gmail.com

DIPLOMACI INTERVISTA

Zv/ministri i Jashtëm, Michael Linhart flet për "GSH": Hapja e negociatave, ndoshta në fund të 2018

Austria: Me këtë sistem drejtësie, s'ka BE

"Bllokimi i arrestimit të Tahirit? Askush të mos fshihet pas autoritetit"

Erl Murati

Për herë të parë në programin e një qeverie shqiptare, Austria është renditur si partner strategjik. Krahas Italisë, Greqisë dhe Turqisë, në programin e "Rama 2", marrëdhëniet me Vjenën kanë marrë rëndësi prioritare.

"Na gëzon fakti që Austria tashmë është bërë pjesë e katërkëndëshit strategjik të Shqipërisë, pasi tregon mirënjohje", - thotë dr. Michael Linhart në një intervistë për "Gazeta Shqiptare".

Zv/ministri dhe sekretari i Përgjithshëm i MPJ-së austriake ndodhet sot në Tiranë për një vizitë zyrtare.

I pyetur nga "GSH" për reformën në drejtësi, Linhart përgjigjet "shqip": "Me këtë sistem drejtësie nuk mund të hyni në BE".

Zyrtari austriak është optimist që Shqipëria mund të hapë negociatat për anëtarësim në BE, brenda gjysmës së dytë të vitit të ardhshëm.

Lidhur me vendimin e Kuvendit për rrezimin e kërkesës së prokurorisë për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Linhart thotë: "Askush nuk duhet të kërkojë dhe të gjejë mbrojtjen e ndonjë autoriteti. Kjo vlen për të gjitha vendet, që dëshirojnë t'i bashkohen kësaj ideje".

Z. Linhart, Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe synon që brenda vitit të ardhshëm të hapë negociatat me BE-në. A mendoni se kjo aspiratë është e mundshme të ndodhë në një periudhë të afërt?

Së pari, dëshiroj të theksoj se kontributi më i mirë për stabilitetin dhe prosperitetin në këtë rajon është integrimi hap pas hapi në Bashkimin Europian. Është mjaft inspiruese të shikosh dëshirën e popullit shqiptar për të qenë pjesë e projektit europian. Në fakt, viti që vjen do të jetë mjaft i rëndësishëm për Shqipërinë dhe do të ofrojë mundësi të mëdha për të. Kjo kohë është një mundësi e mirë për Shqipërinë për të bërë detyrat e shtëpisë dhe për të përmbyshur kushtet, në mënyrë që vendi të marrë mbështetjen e nevojshme për të hedhur hapin tjetër drejt in-



Dr. Michael Linhart

tegrimit. Ne do të jemi-ashu siç kemi qenë edhe në të shkuarën- mbështetës të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Prandaj, ajo që unë do të kërkoja nga qeveria shqiptare do të ishte: Na ndihmoni, që t'ju ndihmojmë!

Shqipëria përgatitet të nisë zbatimin e "reformës në drejtësi", proces i cili përfshin ndryshime në të gjithë strukturën e prokurorisë dhe gjyqësorit në vend. Sa të rëndësishme janë lufta kundër krimit dhe korrupsionit për integrimin në BE të Shqipërisë?

Reforma në drejtësi do të jetë fushëbeteja e Shqipërisë në vitet në vijim. Besoj se nuk ka më kthim prapa, edhe pse po bëhen përpjekje për këtë. Mendoj se ju duhet të filloni të pastroni sektorin e drejtësisë, sepse çdo shoqëri ka nevojë për arbitër final dhe ky arbitër është drejtësia. Por mos më keqkuptoni, ka mjaft "mollë të kalbura" në sektorin e drejtësisë, por unë kam takuar edhe gjyqtarë e prokurorë të shkëlqyer. Nuk është e lehtë të bëhet kështu. Por me këtë sistem që kemi tani, nuk mund të hyni në BE. Pastrimi politik do të vijë gradualisht me krijimin e institucioneve të reja të drejtësisë, si prokuroria speciale për korrupsionin, ashtu siç ka ndodhur edhe në vendet e tjera të rajonit. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është çelësi i progresit të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.



tur si shqetësim ndaj Shqipërisë. Cili është vlerësimi juaj për këto dy çështje?

Për mendimi tim, sundimi i ligjit dhe përmirësimi i gjendjes ekonomike, që do të sillte si pasojë edhe rritjen e cilësisë së jetesës, janë çështjet kyçe për të cilat po punohet në Shqipëri. Pjesa më e



Muajt e kaluar, parlamenti shqiptar pengoi prokurorinë të arrestojë ish-ministrin e Brendshëm, i cili akuzohet për pjesëmarrje në grup kriminal dhe favorizim të trafikut të drogës. A përbën ky një sinjal negativ që politika i jep dhënies së drejtësisë në vend?

Unë jam i bindjes se qytetarët e një shteti duhet të jenë të barabartë para ligjit. Askush nuk duhet të kërkojë dhe të gjejë mbrojtjen e ndonjë autoriteti. Kjo vlen për të gjitha vendet që i janë bashkuar idesë europiane dhe sigurisht edhe për vendet që dëshirojnë t'i bashkohen kësaj ideje. Një tjetër parim i rëndësishëm ligjor është edhe prezumimi i pafajësisë. Prandaj, unë do të kështilloja: t'i lëmë gjykatat të punojnë.

Numri i lartë i azilkërkuësve shqiptarë në vendet e BE dhe trafikun e hashashit kanë qenë dy nga problemet kryesore që partnerët tanë kanë ngri-

shqiptare e ka renditur për herë të parë Austrinë si partnerë strategjike, së bashku me Italinë, Turqinë dhe Greqinë. Cili është vlerësimi juaj për partneritetin mes dy vendeve?

Austria ka qenë ndër shekuj një mike dhe aleate e Shqipërisë. Por, për ta mbajtur të gjallë një marrëdhënie, duhet të investosh në të dhe kjo është pikërisht ajo që Austria ka bërë në këto dy dhjetëvjeçarë e fundit, që nga çlirimi i Shqipërisë nga regjimi totalitar. Na gëzon fakti që Austria tashmë është bërë pjesë e katërkëndëshit strategjik të Shqipërisë, pasi tregon mirënjohje për atë që kemi bërë deri tani. Por kjo është, gjithashtu, edhe një përgjegjësi për të intensifikuar bashkëpunimin. Dhe pikërisht në funksion të thellimit të bashkëpunimit mes dy vendeve tona, Austria, përvëç Konsullatës së saj të Nderit në Shkodër, do të hapë së shpejti edhe një tjetër Konsullatë Nderi në Vlorë.

Për sa i përket marrëdhënieve ekonomike, firmat austriake janë vendosur dhe pozicionuar mjaft mirë në sektorin e financave, sigurimeve dhe hidrocentraleve. Por edhe kultura, që shërben si urë lidhëse mes vendeve, është veçanërisht e rëndësishme për ne: Viti kulturor austriako-shqiptar nën moton "Të (ri)zbulojmë të përbashkëtat", i cili do të jetë vitin që vjen, do t'i afrojë akoma më shumë vendet tona. Në këtë kuadër, për publikun shqiptar do të organizohen aktivitete të larmishme, që përfshijnë nga opera, koncerte me muzikë klasike dhe jazz, ekspozita e deri te konferencat dhe kumtesat shkencore. Për më tepër, për vënie në jetë të këtyre aktiviteteve, një vëmendje e

veçantë do t'i kushtohet edhe pjesëmarrjes së artistëve të njohur shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Austri, si: Eno Peçi (pjesëtar i Trupës së Baletit të Operës Shtetërore të Vjenës), Edison Pashko, (Pjesëtar i Filarmonisë së Vjenës), etj.

Në fillim të këtij viti Austria mori presidencën e OSBE-së për vitin 2017. Cili është kontributi i saj për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht për Shqipërinë në këtë kuadër?

Me marrjen e presidencës së OSBE-së 2017, Austria është angazhuar mjaft për të kontribuar në rivendosjen e stabilitetit dhe rikthimin e besimit në hapësirën e OSBE-së dhe veçanërisht në këtë rajon. Në nivel organizimi të përgjithshëm në një takim ministerial në korrik u arrit që të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për sa i përket personelit, në mënyrë që kjo organizatë të jetë sa më efektive.

Në kërkohë, këtë vit, nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri janë organizuar aktivitete dhe konferenca të ndryshme me tema mbi radikalizimin e luftën kundër trafikut të qenieve nërëzore, si dhe janë ndërmarrë iniciativa mbi antikorupsionin. Gjithashtu, janë vënë në jetë projekte të ndryshme për të rinjtë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në të tjerë, Austria është angazhuar edhe në lidhje me kryerjen e reformës zgjedhore.

Në gjysmën e dytë të vitit 2018 Austria do të marrë presidencën e BE-së. Çfarë duhet të presim konkretisht nga presidencën austriake e BE-së?

Austria është mjaft e angazhuar për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Gjatë presidencës sonë, në çdo këshill të BE-së ne do të japim votën tonë qartë në favor të perspektivës europiane të rajonit. Shpresoj dhe jam besimplotë, që gjatë presidencës austriake të arrijmë të hapim negociatat me Shqipërinë.

Tema të tjera të rëndësishme gjatë presidencës sonë do të jenë mbyllja e bisedimeve për Brexit, si dhe bisedimet për kuadrin shumëvjeçar financiar të ardhshëm.

Policia arrestoi 10 vetë, mes të cilëve edhe nënprefektin e Tiranës

Abuzimi me tokat në Spille, si fitoi Elvis Roshi, Kaja e Lusha

Lutfi Minxhozi: Çfarë iu gjetëm në banesë zyrtarëve

Arrestimi i 10 zyrarëve e ish-punonjësve të Hipotekës e ALUIZNI-t në Kavajë për tjetërsimin e 36 hektarëve tokë shtetërore në Spille zbulon edhe 108 përfituesit e kësaj manovre, të cilët më së shumti janë të afërt të ish-kryebashkiakut Elvis Roshi, kreut të PS në Kavajë Gentian Daja, nënprefektit të Tiranës Fatos Kaja, ish-shefit të Zyrës së Kadastrës në Kavajë, Nezir Lecini si dhe gjyqtari Luan Lusha. Ky i fundit ka qenë në treshen e gjyqtarëve që dënoi me 3 vite burg për "mbajtje pa leje e armëve luftarake" dhe "dhunë në familje", ish-bashkëshortin e gjyqtarës Fildez Hafizi, Fadil Kasemi në vitin 2015. Drejtori për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Policinë e Shtetit, Lutfi Minxhozi tregoi se si ishte ndarë roli i këtyre 10 zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve. Gjatë hetimit proaktiv 9-mujor, këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke abuzuar me detyrën funksionale kanë falsifikuar dhe tjetërsuar 36 hektarë tokë shtetërore ranish të në zonën bregdetare Spille, Kavajë. Këtë sipërfaqe e kanë regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Kavajë (ZRPP), duke përfutur padrejtësisht në interes të tyre dhe personave të tjerë. Mbi bazën e provave të siguruar gjatë hetimit nga strukturat kundër Krimit Ekonomik e Financiar, Prokuroria e Kavajës ka dhënë pëlqimin për masat e arrestit dhe Gjykata e Kavajës ka vendosur sekuestrimin e 36 hektarëve tokë në vijën bregdetare Spille Kavajë, si dhe ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për zyrtarët e administratës shtetërore. Ata akuzohen për veprat penale të "Shpërdorimit të Detyrës", "Falsifikimit të Dokumenteve" dhe "Pastrimit të Produktëve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim. Zyrtarët e lartpërmendur në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë falsifikuar dokumentet, duke bërë ndryshim e zërit kadastral për një sipërfaqe prej 36 hektarë tokë në vijën bregdetare Spille, Kavajë. Në parcelat me numër pasurive 1, 35, 37, 178, duke e tjetërsuar nga "Tokë pa frut" në "Tokë arë", më pas kanë bërë ndarjen në mënyrë të kundërligjshme të kësaj sipërfaqeje tokë, në interes të tyre dhe personave të tjerë. Gjatë hetimeve paraprake dokumentohet bashkëpunimi kriminal midis ish-punonjësve të Komunitetit Kryevendës të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë. Ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin dyshohet se kanë krijuar në mënyrë fiktive komisione për ndarjen e tokës



gjatë periudhës 2013-2016 dhe kanë realizuar tjetërsimin dhe ndarjen në mënyrë të jashtëligjshme të pasurisë shtetërore.

SEKUESTRIMET

Të arrestuarit Dashnor Çullhaj iu gjetën dhe sekuestruan 37 certifikata pronë-

sie, 14 kontrata shitblerjeje pasurie tokë, 6 prokura të posaçme, akti i pjesëtimt vullnetar të pronësisë, shkresa origjinale për Drejtorinë e Pyjeve. Behxhet Pjecit iu gjetën 7 plane rilevimi, disa kërkesa për regjistrim prone, 3 praktika

TE ARRESTUAR

- Fatos Kaja, ish-nënprefekt i Tiranës
- Nezir Lecini, ish-shef i Zyrës së Kadastrës në Kavajë
- Andi Gjeci, juristi i ZVRPP
- Dritan Kazazi, hartograf në ZVRPP
- Bexhet Pjeci, ish-kryetar komune, Kryevindh
- Ilir Kaja, 52 vjeç, agronom në Kryevindh
- Agron Xhelezi, ish-kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokave në Spille
- Dashnor Çullaj, ish-përfaqësues i Kryevindhit në Komisionin e Ndarjes së Tokave
- Altin Copa, aktualisht drejtor i ALUIZNI-t Kavajë
- Enver Duqi, ish-drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Tiranë janë 10 të arrestuarit

Ndërkaq, është shpallur në kërkim S.C., ish-regjistruar i ZVRPP, Kavajë dhe ish-drejtor i Ujësjellësit në Kavajë.

regjistrim prone, disa AMTP etj. Ilir Kajës në bagazhin e makinës private iu gjetën gjatë 8 praktikave për institucionet shtetërore, 6 harta topografike të Spilles, një plan rilevimi. Dritan Kazazit iu gjetën në banesë 23 AMTP, 1 kartelë pasurie dhe

5 kontrata shitblerjeje pasurish. Këto dokumente të sekuestruara lidhen me sipërfaqen e tjetërsuar nga "Tokë shtet" në "Tokë arë". Sipas policisë, ky grup kriminal përpara se të përpilonte certifikatat e pronësisë, fillimisht identifikonte banorët

e mirëbesuar, të cilët do të përfitonin padrejtësisht tokën. Më pas identifikohet blerësi dhe bëhet regjistrimi i menjëhershëm në hipotekë, si dhe akti i shitblerjes së pasurisë. Këto akte në shumicën e rasteve kryeshin pa u vënë në dijeni banorët në emrat e të cilëve përpiloheshin dokumentet e pronësisë. Ilir Kaja, me detyrën agronomi i komunës Kryevindh dhe ish-kryetarët e komunave, Fatos Kaja dhe Bexhet Pjeci, duke pasur dijeni mbi gjendjen faktike të tokës pa frut shtetërore, kanë organizuar fiktivisht komisione të ndarjes së tokës në mënyrë të jashtëligjshme dhe kanë plotësuar fiktivisht AMTP në emër të banorëve, duke u firmosur nga anëtarët e komisioneve si, Agron Xhelezi, Nezir Çullhaj dhe Bajram Dorzi. Komisionet fiktive të ngritura në kundërshtim me ligjin për përpilimin Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP-t) të falsifikuar sikur kjo tokë ishte ndarë që në vitin 2000-2003 kur aplikohet ligji 7501 dhe i dërgonin në ZVRPP Kavajë. Bënin pagesat bankare në emër të personave që do të përfitonin tokën. Pas dërgimit të AMTP-ve në ZVRPP Kavajë, regjistruesi S.C., hartografi Dritan Kazazi, juristi Andi Gjeci dhe protokolli A. Gj., në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë kryer veprimet e kundërligjshme në regjistrimin e pasurive nga "Tokë shtetërore" në "Tokë arë", në dëm të interesave të shtetit.

PERFITUESIT			
<p>■ ROSHI 4300 m² Hida Ismail Elmadhi Azem Selman Rroshi (babai i E.Roshit) Nasije Abdulla Rroshi (nëna e E.Roshit) Renato Abdyl Kodra (djali i tezës E. Rroshit) 4200 m² Xhemile Mersin Çullhaj Elton Hamdi Rroshi (djali i xhaxhait E.Roshit) 2400 m² Xhemal Kasem Hoxha Shpëtim Ferhat Kaja Shqipe Ymer Kaja Servete Ferhat Rroshi Mustafa Selman Rroshi</p>	<p>Shaban Ibrahim Ndrilli Lule Isat Ndrilli 1150 m² Nevruz Kaja Shkëlqim Liman Gjoni Subjekt: "E...G..." 3040 m² Nazmi Kadri Kaja Arkida Besnik Xhiani Dritan Nazmi Kaja Freskida Fatmir Hysaj 2080 m² Fatos Nazmi Kaja Armand Ymer Xhafa 3050 m² Marius Nazmi Kaja Dyzene Hamdi Kaja Nazmi Kadri Kaja Aqif Ramazan Lusha Ledio Rroland Lusha Aqif Rroland Lusha 2535 m² Arben Nazmi Kaja Fluriëna Gjoni 2025 m² Lorenc Nazmi Kaja Qemal Latif Çelislami Zelisha Ramazan Çelislami Luan Qemal Haka Hasan Haxhi Mazari 2000 m² Semiha Remzi Kaja Kleanthi Sokrat Manastirliu 2500 m² Hekuran Abdyl Kaja Muhareem Ramazan Kollçaku Veseli Beu Mynyr Rrapush Beu Agim Rrapush Beu Manushaqe Zyber Gjoci Luan Ramazan Lusha</p>	<p>500 m² Mario Arben Kaja Agron Shygyri Xhelezi Armando Osman Haka Valbona Petrit Haka 2500 m² Hekuran Kaja 300 m² Hekuran Kaja Adrian Tahir Kadriu Bledar Azem Habili Zenel Fadil Dulla Neriman Fatbardh Dulla 1000 m² Hekuran Kaja Isuf Bajram Bulku 1200 m² Hekuran Kaja Zamir Skënder Rosa Shoqeria "Sh..." SHPK 1000 m² Astrit Nazmi Kaja Haziz Fezi Buci Vjollca Daut Buci 2400 m² Arben Nazmi Kaja Manushaqe Hatem Roci Shaziman Zyhdri Hoxha Fluriëna Halil Gjoni Elisa Shefqet Spahiu Subjekt UA.... shpk 2400 m² Pranvera Kaja 2400 m² Reshit Nezir Kaja</p>	<p>Elton Viktor Rrapi Romina Mexhit Rrapi Gezim Jonuz Çeka Sajmir Nezir Leçini (djali i zyrtarit të ZRPP Kavajë, i arrestuar) 1000 m² Vlash Dhori Pjeci Marjosh Nazmi Kaja Celik Behxhet Pjeci 2000 m² Behxhet Pjeci 1000 m² Lindita Pjeci 2560 m² Behxhet Kasem Pjeci Artur Athanas Ziu Freskida Fatmir Hysaj 4000 m² Kasem Sulejman Pjeci Shkëlqim Xhavit Bernaca Durim Xhavit Bernaca Julian Medi Dymrishi Bledi Xhavit Hoxha</p>
<p>■ DAJA 4300 m² Fatmir Muharrem Daja</p>	<p>■ KAJA 2300 m² Reshit Nezir Kaja 4100 m² Kaje Rustem Kaja Shaban Ndrilli Lule Ndrilli Shkëlqim Guma (vëhri i E.Roshit) Pranvera Guma Irisa Shkëlqim Guma (bashkëshortja e Elvis Roshit) Nefsa Selman Berberi 2500 m² Florin Kaja 500 m² Dyzene Kaja 3800 m² Durim Kaja</p>	<p>■ PJECI 4900 m² Mereme Mustafa Pjeci 3260 m² Makbule Bisha Pjeci</p>	<p>■ LECINI 500 m² Jolanda Tafa Defrim Lecini Admirim Sulejman Ferra 800 m² Reshat Elmadhi Fatbardha Qerim Lecini Elisabeta Rexhep Dymrishi Mexhit Çanaku Bakushë Çanaku 3800 m² Myslim Ramiz Elmadhi Nezir Isat Lecini Fatbardha Qerim Lecini Blerim Skënder Rosa</p>

DEKLARIMET E PASURISE VERIFIKIMET

Komisionet e vetingut kanë nisur verifikimin e pasurive të Gjyqësorit

Zbardhen pasuritë e 15 gjyqtarëve, Guxim Zenelaj më i pasuri me 83 mln

Më e "varfra" është Vitore Tusha, që ka vetëm 21 mijë lekë asete

Deklarimet e pasurisë për 15 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë e Kushtetuese janë zbardhur nga "Gazeta Shqiptare". Sipas formularit të vetdeklarimit, marrë nga "Open Data", gjyqtari më i pasur në asete është Guxim Zenelaj me të ardhura vjetore 566 mijë lekë në vit dhe pasuri në vlerë rreth 83 milionë lekë. Pas tij vjen Mirela Fana me të ardhura vjetore familjare 12.3 milionë në vit, plus 51 mijë euro dhe rreth 12.7 milionë asete. Pjesa më e madhe e gjyqtarëve kanë asete me vlerë rreth 4-5 milionë lekë dhe me të ardhura mesatare familjare rreth 2-3 milionë në vit. Më i "varfra" sipas vetdeklarimeve është Vitore Tusha, e cila edhe pse ka të ardhura vjetore 3.4 milionë dhe 12 mijë euro, vlerë pasurie ka 21 mijë lekë. Pas saj vjen Andi Çeliku me 544 mijë lekë asete. Në përgjithësi ka mospërputhje logjike të deklarimeve, ku në shumicën e rasteve nuk kanë specifikuar vlerën reale të shtëpisë sipas çmimit të referencës. Gjithsesi këta gjyqtarë do të jenë pjesë e verifikimit nga komisionet e vetingut, të cilët do të shohin përputhshmërinë e deklarimeve.

ALTINA XHOXHAJ, GJYKATA KUSHTETUESE

1) Të ardhura nga paga si anëtare e Gjykatës Kushtetuese, 1 894 950 lekë.
2) Të ardhura si pedagogje e jashtëme në Shkollën e Magistraturës, 112 500 lekë.
3) Të ardhura si trajnuese, projekti i BERZH-it për trajnimin e gjyqtarëve, 1 500 euro.

Të ardhura nga qiraja e apartamentit në Tiranë, 3780 euro, kontrata e lidhur më 1 nëntor 2013, rifreskuar më 1 nëntor 2014.

1) Bashkëjetuesi Arben Idrizi, të ardhura neto nga paga si sekretar i përgjithshëm në institucionin e Presidentit të Republikës, 1 490 880 lekë.

2) Bashkëjetuesi Arben Idrizi, dieta, shërbime jashtë vendit në funksionin e sekretarit të përgjithshëm, 1 985 dollarë.

Kursime nga të ardhurat nga paga e vitit 2014, 1 100 000 lekë.

ANDI ÇELIKU GJYKATA E LARTË

Të ardhura nga paga si gjyqtar, 1 566 456 lekë.

1) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar me - 1 126 euro, gjendja dt. 31.12.2016, 2069 euro.

2) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë, llogari page, shtuar me + 42 077 lekë, gjendja dt. 31.12.2016, 54 636 lekë.

3) Gjendja e llogarisë bankare në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar me 3 228 euro, gjendja dt. 31.12.2016, 2 054 euro.

4) Gjendja e llogarisë "Futura" në emër të djalit, shtuar me + 1 306 euro nga paga dhe dhuratat nga të afërmit.

ARJANA FULLANI GJYKATA E LARTË

Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga Gjykata e Lartë për vitin 2016, 1 566 456 lekë.

1) Të ardhura nga interesat bankare, 37 216 lekë, pjesë e regjimit martesor (50 % me 50 % me bashkëshortin).

2) Të ardhura nga interesat e bonove të thesarit, 624 750 lekë, pjesë e regjimit martesor (50 % me 50 % me bashkëshortin).

1) Pasuria në bashkëpronësi, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin), është dhënë me qira në datë 09.12.2016. Asnjë përfitim deri në datë 31.12.2016.



2) Të ardhura pas zgjatjes së kontratës së qirasë për një apartament, 420 000 lekë, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin).

Bashkëshorti, z. Adrian Fullani, të ardhura si subjekti tregtar, 383 265 lekë.

1) Bashkëshorti, zoti Adrian Fullani, të ardhura 6 092 865 lekë.

2) Bashkëshorti, zoti Adrian Fullani, të ardhura 14 040 euro.

3) Vajza, znj. Fiona Fullani, të ardhura nga paga, 718 341 lekë.

Të ardhura nga detyrime të shlyera nga të tretët, të ardhura nga shitja e tokës, kësti i parë, 38 503 euro, pjesë e regjimit martesor: Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion.

Të tjera

1) Zgjidhet marrëveshja për shërbime teknike, e deklaruar në parë.

2) Shtesë në llogarinë bankare, 42 102 euro, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin).

3) Pakësim në llogarinë bankare, 4 128 766, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin).

4) Shtesë në llogarinë bankare, 6 139 536 lekë, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin).

5) Gjendja cash, 200 000 lekë, pjesë e regjimit martesor, (50 % me 50 % me bashkëshortin).

6) Kredi bankare në Bankën e Shqipërisë për blerjen e një apartamenti banimi në shumën 11 400 000 lekë. Shuma e shlyer 409 291 lekë, detyrimi financiar mbetur i pashlyer, 8 065 484 lekë, pjesë e regjimit martesor.

BASHKIM DEDJA, GJYKATA KUSHTETUESE

1) Të ardhura nga paga si kryetar i Gjykatës Kushtetuese, 2 215 140 lekë.

2) Të ardhura nga paga si pedagog i jashtëm i Shkollës së Magistraturës, 39 320 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

1) Bashkëshortja, të ardhura nga paga si nëndrejtoresh tek shkolla "Jeronim De Rada", 74 450 lekë.

2) Bashkëshortja, të ardhura nga ISSH

si pagesa për barrëllindje, 290 416 lekë.

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion 1.02.

Të tjera

1) Gjendje llogari bankare e pagës, 60 901 lekë.

2) Detyrime të papaguara në vlerën 15 100 005 lekë për kredi bankare marrë më 02.12.2013 për blerje apartamenti dhe garazh me principal 16 800 000 lekë, afat shlyerjeje 20 vjet, këst mujor 109 1118 lekë dhe interes 5.04%, bashkëshortja si dorëzane.

3) Bashkëshortja, gjendje llogarisë bankare të pagës, 293 116 lekë.

BESNIK IMERAJ, GJYKATA KUSHTETUESE

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet

Të ardhura nga paga neto si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, 1 896 470 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

Vajza, Marsela Imeraj, të ardhura nga paga si avokate, 1 207 780 lekë.

1) Gjendja në llogarinë e pagës, në një bankë të nivelit të dytë, 80 000 lekë.

2) Gjendja në llogarinë e pagës, në një bankë të nivelit të dytë, 700 000 lekë.

3) Depozita në emër të vajzës, në një bankë të nivelit të dytë, 920 462 lekë.

4) Kredi në bankë të nivelit të dytë me vlerë detyrimi financiar të pashlyer - 2 132 027 lekë, e marrë për blerje banese.

EDMOND ISLAMI, GJYKATA E LARTË

Të ardhura nga paga dhe shpërblimet Të ardhura nga paga neto si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, 1 566 462 lekë.

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies

Të ardhura nga interesat bankare të një depozite, 11 611 lekë.

Të tjera

1) Gjendja e një depozite kursimi në një bankë të nivelit të dytë, kursime nga paga ndër vite, 20 000 euro.

2) Kartë krediti në bankë të nivelit të dytë me limit 200 000 lekë, limiti i patërhequr.

3) Bashkëjetuesja, zonja Sonila Toska, gjendja e llogarisë depozitë në një bankë të nivelit të dytë, të ardhura familjare ndër vite, 15 000 euro.

4) Bashkëjetuesja, zonja Sonila Toska, kartë krediti me limit 300 000 lekë, limiti i patërhequr.

EVELINA QIRJAKO, GJYKATA E LARTË

Të ardhura nga paga dhe shpërblimet

1) Të ardhura nga paga neto, 1 566 456 lekë.

2) Të ardhura nga pagesa e fondacionit "Slym Foundations" për trajnimin e gjyqtarëve pranë Shkollës së Magistraturës, 354 euro.

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies

1) Të ardhura nga interesat bankare, 9 022,18 lekë.

2) Të ardhura nga interesat e llogarive dhe depozitave, 991,34 euro.

Të ardhura qiradhënie

1) Të ardhura nga qiratë, 40 622 euro.

2) Të ardhura nga qiratë, 2 958 000 lekë.

Të ardhura nga bizneset dhe sipërmarrjet individuale: Nuk ka.

Të ardhurat nga ortakëri/aksione: Nuk ka.

Të ardhura nga publikimet dhe e drejta e autorit: Nuk ka.

Të ardhura nga çelje Trashëgimi: Nuk ka.



Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare: Nuk ka

Të ardhura nga detyrime të shlyera nga të tretët

Të ardhura nga shitja e një apartamenti me sip. 67 m² në Kavajë, 22 000 euro.

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

1) Gjendja e llogarisë rrjedhëse në një bankë të nivelit të dytë, në fillim viti ishte 4.68 euro, shtuar me 6 938.18 euro nga qiratë e paguara nga shoqëria "Service-Factory" shpk, gjendja në fund të vitit 6 942.86 euro.

2) Gjendja e llogarisë së kursimit, pakësuar me - 38.18 euro, gjendja në fund të vitit 0 euro.

3) Gjendja e llogarisë depozitë, shtuar me + 64.97 euro nga interesat, gjendja në fund të vitit 153 939 euro.

4) Gjendja e llogarisë bankare, shtuar me + 2 726 050 lekë nga të ardhurat e qirave të paguara nga Instituti i Politikave Publike dhe Private si dhe një qytetar sipas kontratave të qirave, gjendja në fund të vitit gjendja është 3 594 3000 lekë.

5) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 325 274 lekë, gjendja në fund të vitit 41 787 lekë.

6) Gjendja e llogarisë bankare në euro, llogari e celur gjatë vitit të deklarimit në fund të vitit është zero, llogaria është hapur për të arkatuar cmimin e shitjes apartament në Kavajë, në datën 26. 07. 2016 janë derdhur 22 000 euro, kjo shumë është pakësuar me - 22 000 euro.

7) Gjendja e llogarisë bankare, të ardhura nga qiratë pakësuar me - 41 841 euro, gjendja në fund të vitit 14 867 euro.

8) Gjendja e llogarisë rrjedhëse pakësuar me - 749.93 lekë, gjendja në fund të vitit 100.79 lekë.

9) Gjendja e llogarisë bankare, pakësuar me - 189 912.78 lekë, gjendja në fund të vitit 0 lekë.

10) Gjendja e llogarisë depozitë, shtuar me + 987.52 euro, të ardhura në vite nga shitblerje, qira apo lekë të marra nga bankat e tjera, gjendja në fund të vitit 197.309 euro.

11) Gjendja e llogarisë së kursimit, pakësuar me - 8 166.38 euro, gjendja në fund të vitit 3.61 euro.

12) Gjendja e llogarisë bankare, pakësuar me - 67 123.45 lekë, gjendja në fund të vitit 0 lekë.

13) Gjendja e llogarisë bankare, pakësuar me - 4.47 dollarë, gjendja në fund të vitit 3 257 dollarë.

14) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 2 201.46 euro, gjendja në fund të vitit 0 euro.

15) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 9 113 euro, gjendja në fund të vitit 4 806.29 euro. Në këtë llogari derdhet vlera e qirasë nga shoqëria "Nordic Investment".

16) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 373.06 euro, gjendja në fund të vitit 0 euro, llogaria është mbyllur.

17) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 320 282.70 lekë, gjendja në fund të vitit 0 lekë, llogaria është mbyllur.



18) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 2 508.89 dollarë, gjendja në fund të vitit 0 dollarë, llogaria është mbyllur.

19) Gjendja e llogarisë rrjedhëse, pakësuar me - 17.25 CHF, franga zvicerane, gjendja në fund të vitit 0, llogaria është mbyllur.

FATMIR HOXHA, GJYKATA KUSHTETUESE

Të ardhura nga paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, 1 896 470 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare Bashkëshortja, të ardhura nga paga si inspektor pranë Komisionerit Kundër Diskriminimit, 710 280 lekë.

Të tjera
1) Bashkëpronar me 50 %, me bashkëshorten Rudina Hoxha i një banesë në Shkodër, sip. 65 m², shitur me vlerë 3 400 000 lekë.

2) Kredi në bankë të nivelit të dytë me vlerë detyrimi financiar të paslyer - 4 609 533 lekë, marrë në datën 27.05.2012, afat shlyerje 60 muaj, normë interesi 6 %.

3) Kredi në një bankë të nivelit të dytë, detyrimi financiar i paslyer - 233 336 lekë, marrë më datë 14.07.2014, me principal 250 000 lekë, afat shlyerje 60 muaj, normë interesi 6 %.

4) Detyrim në vlerën 37 850 euro ndaj subjektit "Gener-2" shpk (ish "Vigan Konstruktion" dhe "Ish - Daniela" shpk., për blerje banese.

5) Detyrim huaje 9 900 euro, ndaj shtetasi Ardiyan Guri.

6) Detyrim 404 145 lekë, për prekje overdrafti gjatë viteve 2013 - 2014.

GANI DIZDARI, GJYKATA KUSHTETUESE

Të ardhura nga paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, 1 896 470 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

1) Bashkëjetuesja, Shefik Kortoci, të ardhura nga paga si arsimtar nga viti 1997 - 2012; nga puna përkohësisht në INSTAT, qarku i Kukësit dhe kontribut nga vëllezërit, 1 415 000 lekë.

2) E bija, Anisa Dizdari, të ardhurat si notere të Dhoma e Noterisë, Tiranë, 301 304 lekë.

GUXIM ZENELAJ, GJYKATA E LARTË

Të ardhura nga paga dhe shpërblymjet si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, 1 566 456 lekë.

Të ardhura nga Bonuse: Nuk ka

Të ardhura qiradhënie

Të ardhura nga qiraja për një lokal dhe ambient banimi në Shëngjin, 30 000 euro.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare Nëna, të ardhura nga pensioni, 122 676 lekë.

Të tjera

1) Fituar pronësi 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë sipërfaqe 292.62 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

2) Fituar pronësi 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë me sipërfaqe 66 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt.



02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

3) Fituar pronësi 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 67.35 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

4) Fituar pronësi, 100 % të një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, sipërfaqe 54.46 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

5) Fituar pronësi me 100 % i një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, sipërfaqe 60.36 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, me shoqëri ndërtimi data 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

6) Fituar pronësi me 100 % i një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, sipërfaqe 51.35 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

7) Fituar pronësinë 100 % të një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, sipërfaqe 54.46 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, me shoqëri ndërtimi të datës 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

8) Fituar pronësi me 100 % i një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, sipërfaqe 66.58 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, data 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

9) Fituar pronësi, 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 59 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, data 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

10) Fituar pronësinë me 100 % i një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 55 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

11) Fituar pronësinë me 100 % i një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 54.46 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

12) Fituar pronësinë 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 55 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

13) Fituar pronësinë 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 67.36 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

14) Fituar pronësinë me 100 % i një apartamenti në ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 51.35 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

15) Fituar pronës 100 % i një apartamenti në ishullin Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 54.46 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

16) Fituar pronësinë 100 % të një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 55 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

17) Fituar pronësinë 100 % i një apartamenti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 54 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, datë 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

18) Fituar pronësinë 100 % të një aparta-

menti në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 61 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

19) Fituar pronësinë me 100 % të një njesie në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 16 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes, dt. 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

20) Fituar pronësinë 100 % të një njesie në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 15 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë, përfituar sipas kontratës së sipërmarrjes me shoqëri ndërtimi, datë 02.10.2008 dhe kontratës 07.10.2016.

21) Fituar pronësinë 100 % të një njesie në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 218.06 m², regjistruar pranë ZVRPP Lezhë. Me kontratën noteriale datë 14.09.2007 dhe kontratën noteriale datë 14.09.2007 janë dy sipërfaqe trualli 1941 m² në ishullin Shëngjin, Lezhë të regjistruara pranë ZVRPP Lezhë, vlera e blerjes së truallit deklaruar nga vetë subjekti është 16 000 euro, të ardhura këto të përfituara nga shitja e shtëpisë në Rr. "Don Bosko", shitje e bërë në vlerën 55 000 euro në datën 26.10.2005. Për këtë sipërfaqe trualli është lidhur kontrata e sipërmarrjes dt. 02.10.2008 për ndërtimin e objektit nga e cila do të përfitohej 2/3 e 40 % të sipërfaqes ndërtimore. Me kontratën dt. 07.10.2016 është realizuar shkëmbimi përfundimtar i truallit me shoqërinë ndërtuese nga ku është realizuar edhe ndarja faktike e sipërfaqes ndërtimore.

MIRELA FANA, GJYKATA E LARTË

Të ardhura neto pasi ka është paguar tatimi mbi të ardhurën personale dhe kontributet 1 576 316 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë.

2) Të ardhura mësimdhënie në Universitetin "Luarasi" 139 046 Lekë.

3) Të ardhura nga mësimdhënia në shkollën e Magjistraturës 11 900 lekë.

Të ardhura nga Bonuse

Të ardhura si këshilltarë/anëtarë bordesh të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies

Të ardhura qiradhënie

1) Të ardhura nga depozitave bankare 78 568 lekë.

2) Të ardhura nga qiraja 941 800 lekë.

3) Të ardhura nga pagesa e qirasë studio ligjore 297 500 lekë.

4) Bashkëshorti, zoti Neshat Fana të ardhura nga puna zyra e avokatisë 7 893 500 lekë.

5) Bashkëshorti, tërheqje nga një shoqëri tregtare 10 115 000 lekë ku nuk deklarohet arsyja e tërheqjes.

6) Vajza, zonja Krisilda Fana të ardhura nga punësimi pranë Presidencës 807 560 lekë.

7) Vajza, zonja Krisilda Fana të ardhura nga puna si pedagogje në universitetin "Beder" 40 000 lekë.

8) Djali, Frenki Fana të ardhura nga puna në "Phoenix-Petrolium" sha., 501 380 lekë.

Të tjera

1) Gjendje në llogari bankare të bashkëshortit si person fizik, 1 731 euro.

2) Gjendje në llogari bankare të bashkëshortit si person fizik, 864 938 lekë.

3) Bashkëshorti, gjendje në llogari bankare 938 831 lekë.

4) Bashkëshorti, gjendje në llogari bankare si individ 831 euro.

5) Vajza gjendje në llogari bankare, 30 134 lekë.

6) Vajza gjendje depozitë bankare, 400 000 lekë.

7) Vajza llogari kursimi, 21 513 lekë.

8) Djali gjendje llogari rrjedhëse 82 774 lekë.

SHKËLZEN SELIMI, GJYKATA E LARTË

1) Paga si anëtar i Gjykatës së Lartë 1 576 316 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë.

2) Të ardhura të fituara nga paga si pedagog i jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës, 40 844 lekë.

Të ardhura qiradhënie

1) Të ardhura nga qiradhënia e pronë e bashkëshortëve, pikë karburanti në Vlorë, periudha janar maj 21 250 (njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë euro).

2) Të ardhura nga qiraja e karburantit qershor-dhjetor, 2015 vlera 29 750 (njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

Bashkëshortja, zonja Rilinda Selimi, të ardhura të fituara nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrativ 1 218 864 (një milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

Të tjera

1) Depozitë me afat, 39 097 euro vënë nga qiradhënia.

2) Kursime të vëna nga pagat e bashkëshortëve, 815 608 lekë.

3) Depozitë po nga të ardhurat e qira, pika e karburantit, 8 510 euro.

4) Depozituar për të marrë kartë krediti, 3 900 euro.

TOM NDRËCA, GJYKATA E LARTË

Paga vjetore 1 576 316 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

1) Paga e bashkëshortes, zonja Kristina Ndreca, pranë Institutit të Gjeoshkencës 790 899 (shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

2) Paga e djalit, zoti Erion Ndreca, pranë Ministrisë së Drejtësisë 836 655 (tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

3) Paga e djalit, zotit Erind Ndreca, pranë drejtorisë Z. V. R. P. P. Vlera 616 536 (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

Të tjera

Kursime familjare cash 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

VITORE TUSHA, GJYKATA KUSHTETUESE

1) Të ardhura nga paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, 1 896 470 lekë.

2) Të ardhura nga paga si lektor në Universitetin "Iliria", 27 000 lekë.

3) Të ardhura nga paga si lektor në Universitetin "Luarasi", 189 601 lekë.

4) Të ardhura nga Shkollia e Magjistraturës, si eksperte në "Trajnimin vazhduar të gjyqtarëve", 1 484 euro.

Të ardhura nga bonuse

Të ardhura nga punësimi part-time, 860 000 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

1) E bija, Renisa Tusha, të ardhura nga punësimi në Milano, Itali, 11 089 euro.

2) E bija, Elira Tusha, të ardhura nga paga të Avokatura e Shtetit, janar-prill 2014, 221 565 lekë.

3) E bija Elira Tusha, të ardhura nga aktiviteti privat - noteri, tetor - dhjetor 2014, 232 632 lekë.

Të tjera

1) Gjendja në llogarinë bankare në një bankë të nivelit të dytë, 1 543 lekë.

2) Gjendja në llogarinë bankare në një bankë të nivelit të dytë, 69 euro.

3) Gjendja në llogarinë një bankë të nivelit të dytë, 9 751 lekë.

4) Detyrim në shumën 25 000 euro.

5) E bija, Renisa Tusha, gjendje e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, 183 euro.

6) E bija, Elira Tusha, pakësim i gjendjes së llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, - 31 700, overdraft.

VLADIMIR KRISTO, GJYKATA KUSHTETUESE

Të ardhura vjetore nga paga, 1 896 470 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e certifikatës familjare

1) Bashkëshortja, të ardhura vjetore nga puna si notere, 432 794 lekë.

2) Bashkëshortja, të ardhura nga pensioni, 164 400 lekë.

Të tjera

1) Gjendja e depozitës, bono thesari, në Bankën e Shtetit, nëpërmjet një banke të nivelit të dytë, 19 000 euro.

2) Gjendja e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar me - 117 500 lekë.

3) Gjendja e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar me - 2 658 000 lekë.

4) Gjendja e depozitës në Bankën e Shtetit, obligacione me afat 2-vjeçar, 2 658 000 lekë.

5) Bashkëshortja, gjendja e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë, pakësuar me 689 800 lekë.

6) Bashkëshortja, gjendja e depozitës në Bankën e Shtetit në bono thesari, 689 800 lekë.

OPERACIONET ANTIDROGE ARRESTIMET

Policia: Trafikuan kokainë, heroinë dhe kanabis brenda e jashtë vendit

FIER

Operacioni "Forca e ligjit" ka nisur nga Fieri. Tre persona, pjesë e një grupi kriminal që akuzohen për trafik droge, vrasje e rrëmbime kanë përfunduar në pranga. Bëhet fjalë për 45-vjeçarën Kujtim Kuçi dhe 43-vjeçarën Bashkim Ahmeto nga fshati Sulaj i Fierit dhe 47-vjeçarën Dritan Tusha, 47 vjeç. Mësohet se personat në fjalë u arrestuan në momentin që ndodheshin në ambientet e një bar-kafe në fshatin Fermë Çlirim, ndërsa nuk kanë bërë rezistencë. Lajmi është bërë me dije nga drejtori i Policisë së Fierit, Albert Nushi. Gjatë një konference për mediat, ai njoftoi rezultatet e operacionit ku janë sekuestruar armë zjarri, lëndë narkotike si dhe katër automjete, një prej të cilave e blinduar. Gjithashtu, policia po heton pasuritë e këtij grupi kriminal, ku në verifikim janë një resort, dy banesa në Tiranë dhe një në Golem.

OPERACIONI

Policia e Fierit në bashkëpunim me Drejtorinë e Vlorës, Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale dhe FNSH finalizuan operacionin policor të koduar "Grand", ku u arrestuan në flagrancë 3 persona, të skeduar si anëtarë të një grupi me tendencë të theksuara kriminale në fushën e narkotikëve, vrasjeve e rrëmbimit të personit. Sipas bluve, arrestimi i shtetasve Kujtim Kuçi, Bashkim Ahmeto dhe Dritan Tusha u krye mbi bazën e informacioneve të siguruar në rrugë operative se dispononin lëndë narkotike. Mbi bazën e këtyre të dhënave, u ushtrua kontroll në lokalitë në pronësi të shtetasit Kujtim Kuçi, në fshatin Fermë Çlirim. Gjatë ndërhyrjes në ambientet e lokalit, blutë kanë ndaluar personat e mësipërm. Mësohet se gjatë kontrollit, Kujtim Kuçi iu gjet dhe sekuestrua një armë zjarri e markës "Glock" dhe 2 krehra me fishekë. Bashkim Ahmetos iu gjet dhe sekuestrua 1 pako me lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa, 1 armë zjarri pistoletë e markës "Glock" dhe një krehër me fishekë. Ndërsa, shtetasit Dritan Tusha iu gjet dhe sekuestrua një sasi lëndë narkotike e dyshuar kanabis sativa. Në përfundim të veprimeve të para hetimore janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale veç armëve të zjarrit dhe drogës edhe 4 automjete, njëra e blinduar; 2 armë gjahu; 1 dedektor valësh; 1 shkop gome; 2 thika me për-

Nis operacioni "Forca e ligjit, kapen 3 persona në Fier për drogë e vrasje

Kujtim Kuçi, Bashkim Ahmeto dhe Dritan Tusha u arrestuan në lokal, lëviznin me makina të blinduara



Operacioni "Forca e ligjit" në Fier

GRUPI KRIMINAL

Sipas burimeve nga policia e Fierit, 3 personat e prangosur si anëtarë të grupit të strukturuar kriminal dyshohet se ndër vite në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë trafikuar lëndë narkotike të llojit kokainë, heroinë dhe kanabis sativa brenda dhe jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, ky grup kriminal që operonte kryesisht në zonën e Fierit dyshohet se ka qenë i përfshirë në disa ngjarje të rënda si vrasje e rrëmbim personi.

OPERACIONI I KODUAR "GRAND" NË FIER

■ PERONAT E ARRESTUAR

1. Kujtim Kuçi, 45 vjeç, banues në fshatin Sulaj, Fier.
2. Bashkim Ahmeto (Kuçi), 43 vjeç, banues në fshatin Sulaj, Fier.
3. Dritan Tusha, 47 vjeç, lindur dhe banues në Shijak.

■ ARMËT E MATERIALET E SEKUESTRUARA

- 4 automjete, njëra e blinduar
- 2 armë gjahu
- 1 dedektor valësh
- Shkop gome
- 2 thika me përmasa të ndryshme
- 8 telefona celularë
- 900 euro

■ PASURITË E IDENTIFIKUARA

- 1 kompleks shërbimesh në fshatin Fermë Çlirim, ku përfshihen hoteleri, restorant, pikë karburanti.
- 2 automjete.
- 2 banesa në Tiranë dhe 1 në Golem.

masa të ndryshme; 8 telefona celularë dhe 900 euro.

HETIMET

Sipas burimeve nga policia e Fierit, 3 personat e prangosur si anëtarë të grupit të strukturuar krim-

inal dyshohet se ndër vite në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë trafikuar lëndë narkotike të llojit kokainë, heroinë dhe kanabis sativa brenda dhe jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, ky



Ministri Xhafaj: Të vendosur për spastrimin e kimit

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka përsëritur aksionin e policisë "Forca e ligjit" në qytetin e Fierit, ku u arrestuan 3 persona. Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", Xhafaj theksoi se kjo është goditja e parë ndaj grupeve të narko-trafikut, ndërsa shpreh vendosmërinë në vijimin e këtij aksioni. "Në Fier u realizua goditja e parë e 'Forca e ligjit'. Një grup me pak nga lista e narkotrafikut, tashmë i asgjësuar. Përgjegjësi policisë Fier dhe strukturave të drejtorisë qendrore për këtë sukses! Të vendosur për spastrim të plotë të grupeve kriminale dhe sekuestrim të aseteve të tyre", shkruan ministri Xhafaj.

Operacioni "Forca e ligjit" në Fier

OPERACIONI



Tre të "fortët" përdornin dedektor valësh për të mos u përgjuar nga policia

Policia ka sekuestruar në sendet e Kujtim Kuçit, Bashkim Ahmetos dhe Dritan Tushës edhe një dedektor valësh, që shërben për bllokimin e përgjimeve. Bëhet fjalë për një pajisje që zbulon nëse në një rreze të caktuar ka apo jo valë dhe që përdoret për të krijuar perimetër sigurie, ku mund të mbrohen nga përgjimi apo influenza e çfarëdolloj vale, në këtë rast nga policia. Burime nga blutë bënë me dije se pikërisht kjo pajisje i ka vështirësuar punën grupit hetimor dhe efektive që ishin në ndjekje të tre personave të mësipërm, pasi nuk mund të kishin përgjime ambientale. Një dedektor valësh kushton rreth 3-4 mijë euro.

grup kriminal që operonte kryesisht në zonën e Fierit, dyshohet se ka qenë i përfshirë në disa ngjarje të rënda si vrasje, rrëmbim personi, për të cilat po vijojnë hetimet intensivisht.

Paralelisht me hetimin penal, policia ka nisur edhe hetim për të gjitha pasuritë që zotërojnë anëtarët e grupit, të dyshuara si produkt i pastrimit të veprës penale të kryer prej tyre. Deri tani janë identifikuar disa prej pasurive, si: 1 kompleks shërbimesh në fshatin Fermë Çlirim, ku përfshihet hoteleri, restorant, pikë karburanti; 2 automjete; 2 banesa në Ti-

ranë dhe 1 në Golem. Materialet i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Operacioni "Forca e ligjit" do të vazhdojë intensivisht deri në realizimin të plotë të objektivit për shkatërrimin e të gjitha grupeve të skeduar kriminale dhe sekuestrimin e aseteve



TIRANË - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda pranon gjykimin e shkurtuar për disa nga të dënuarit e çështjes së laboratorit të kokainës në fshatin Xibrakë të Elbasanit. Kështu, nga ky vendim i Krimeve të Rënda lehtësohen disa prej të dënuarve, duke përfituar nga 2-4 vite burg më pak për të vuajtur në qeli. Konkretisht nga vendimi i dhënë, nipi i ish-diktatorit Enver Hoxha, Ermal Hoxha, i cili ishte dënuar me 10 vite burg, për shkak të gjykim-it të shkurtuar do të vuajë 6 vite e 8 muaj burgim. Ilir Hyseni ishte dënuar me 12 vite, ndërsa tashmë do të vuajë 8 vjet burg. Dy kolumbianët Cesar Avila e Valther Moreno ishin dënuar me nga 12 vite do të vuajë nga 8 vjet burg.

Gjykimi i shkurtuar, Ermal Hoxha do të vuajë 6.8 vite burg

Apeli i Krimeve të Rënda lehtëson grupin "Xibraka", ul dënimet në 64.9 vite nga 104 që dha Shkalla e Parë



Ermal Hoxha



PJESTARËT E GRUPIT "XIBRAKA"

- 1.ERMAL HOXHA
- 2.IILIR HYSENI
- 3.CESAR AVILA
- 4.VALTHER MORENO
- 5.GENCI XHIXHA
- 6.ARJAN DALIPI
- 7.GENTIAN GJONAJ
- 8.KELMEND DALIPI
- 9.SAJMIR BATKU

Genci Xhixha nga 13 vite burg, do të vuajë 8 vjet e 7 muaj. Dënimi ndaj tij është dhënë në mungesë, pasi vijon të jetë ende në kërkim nga policia. Arjan Dalipi do të vuajë 6.7 vite burg, nga 10

vite që kishte vendosur Shkalla e Parë. Gentian Gjonaj do të vuajë 7.3 vite burg, nga 11 vite që ishte dënuar. Kelmend Dalipi do të vuajë 7.3 vite burg, ndërsa Sajmir Batku do të vuajë 8.7 vite

burg. Në vendimin e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, shpallur në 11 korrik të këtij viti, të pandehurit u deklaruan të fajshëm dhe u dënuan me 104 vite burg në total.

Operacioni "Ndalesa e Fundit"/Policia: Trafikantët lëviznin me "Golf 5", ja si u kapën në Malësi të Madhe

Trafik droge drejt Malit të Zi, 2 persona në pranga

Sekuestrohen 70 kg kanabis, në kërkim edhe 3 të tjerë nga Fushë-Kruja

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një tjetër sasi droge është sekuestruar nga policia e Shkodrës në bashkëpunim me blutë e Malësisë së Madhe dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH). Vetëm pak ditë pas bllokimit të sasisë prej 1.5 tonë kanabis në fshatin Vilun të Velipojës, dje blutë e qytetit verior gjatë operacionit të koduar "Ndalesa e Fundit" kanë ndaluar një automjet tip "Golf 5" pranë pikës kufitare të Hanit të Hotit, ku u gjet dhe u sekuestrua 70 kg kanabis, e cila kishte si destinacion Malin e Zi. Mësohet se gjatë këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shoferit dhe pasagjerit të automjetit. Bëhet fjalë për 26-vjeçarin Fatbardh Hoxha, banues në fshatin Komes të Fushë-Krujës dhe të 29-vjeçarit Kledi Xeka 29 vjeç, banues në fshatin Halilaj të Fushë-Krujës. Ndërkohë, janë shpallur në kërkim edhe tre persona të tjerë nga fshati Kamas i Fushë-Krujës.

ARRESTIMI

Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës bënë me dije se arrestimi i Fatbardh Hoxhës u



Operacioni antidrogë në Shkodër



1.5

TONË DROGË

Pak ditë më parë, policia e Shkodrës sekuestroi në fshatin Vilun të Velipojës një sasi prej 1.5 tonë kanabis, ndërsa vuri në pranga 8 persona, mes të cilëve edhe efektivin e policisë, Enriko Zyle. Të martën, Gjykata e Krimeve të Rënda caktoi masën e sigurisë "arrest me burg" për 6 nga 8 personat e arrestuar.

bë, pasi në afërsi të një karburanti në fshatin Grizhë në Malësi të Madhe iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale rreth 70 kg kanabis, që e kishte në automjetin e tij tip "Golf 5" me targë AA 077 RZ. Po si-

pas këtyre burimeve, arrestimi i shtetasit Kledi Xeka (ishte në drejtim të mjetit "Golf 5" me targë AA 911 RV) u bë pasi në bashkëpunim me personat e tjerë po shoqëronin 26-vjeçarin Fatbardh Hoxha për trans-

portimin e lëndës narkotike. Gjithashtu, policia sqaroi se shtetasit e shpallur në kërkim sapo kanë parë policinë, janë larguar, pasi të dyja mjetet kanë qenë të parkuara tek karburanti. Efektivët kanë ngritur pika kontrolli dhe po punohet për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim dhe bashkëpunëtoreve të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Dy të arrestuarit akuzohen për veprat penale të "prodhimi dhe shitja e narkotikëve e kryer në bashkëpunim".

TRAFIKU I DROGËS

Sipas hetuesve të çështjes, droga e sekuestruar në aksin Shkodër-Hani Hotit kishte për qëllim që të transportohej drejt Malit të Zi. Ndërsa, nuk përjashtohet mundësia që sasia e lëndës narkotike të kishte si destinacion final Italinë. Trafikantët kishin arritur deri në fshatin Grizhë dhe më pas aty kanë bërë një ndalesë. Policia dyshon se do të ndërroheshin mjetet për të qenë sa më larg gjurmëve të policisë dhe droga që u sekuestrua do të transportohej me makina të tjera dhe jo me ato që kishin shkuar deri në Grizhë. Pasi kanë parë se Fatbardh Hoxha dhe Kledi Xeka janë vënë në pranga nga policia, personat e tjerë që janë shpallur në kërkim, janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes.

OPERACIONI ANTIDROGË NË MALËSINË E MADHE

■ TË ARRESTUAR

Fatbardh Hoxha 26 vjeç, banues në Komes, Fushë-Krujë.
Kledi Xeka 29 vjeç, banues në fshatin Halilaj, Fushë-Krujë.

■ NË KËRKIM

A. B., banues në fshatin Kamas, Fushë-Krujë.
S. H., banues në fshatin Kamas Fushë-Krujë.
E. X., banues në fshatin Kamas Fushë-Krujë.

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda dënoi dje me 20 vite burg, Ergys Kolaverin. Ky i fundit akuzohet se është autori i atentatit me snajper në burgun e Vaqarrit, ngjarje kjo e ndodhur në korrik të vitit të shkuar. Për Kolaverin, Prokuroria e Krimeve të Rënda kishte kërkuar dënimin me 30 vite heqje lirie. Ndërkaq, Ergys Kolaveri nuk e ka pranuar në asnjë rast se është personi që ka qëlluar me snajper në bur-



Ergys Kolaveri

Atentati me snajper në burgun e Vaqarrit, dënohet me 20 vite heqje lirie Ergys Kolaveri

gun e Vaqarrit. Në dosjen e prokurorisë thuhet se pasditen e 30 korrikut të 2016-ës, i pandehuri organizoi një atentat ndaj Gazmir Daçit, i cili ndodhej në burgun e Vaqarrit në pritje të gjyqimit për vrasjen e Gazmir Kolaverit dhe plagosjen rëndë të Robert Kolaverit. Këta dy të fundit janë vëllezër të Ergys

Kolaverit. Në momentin që ka ndodhur ngjarja, Gazmir Daçi ishte duke dalë në ajrim, kur është qëlluar me snajper nga një kodër aty pranë. Plumbi nuk kapi Gazmir Daçin, që dyshohej të ishte edhe objektivi i këtij atentati, por një të dënuar nga Kosova. Sipas prokurorisë, Kolaveri ishte i pajisur me një

armë të sofistikuar snajper dhe ishte vendosur në një distancë të largët në ambientet e jashtme të burgut dhe priti derisa Gazmir Daçi doli në ajrim për ta qëlluar. Po sipas prokurorisë, autori kryesor i kësaj ngjarjeje është Ergys Kolaveri dhe se atentati ndaj Daçit ishte për gatitur për hakmarrje.

SHKURT

Prokuroria i dërgon KLD-së vendimin për gjyqtarin e arrestuar

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda i ka dërguar dje KLD-së vendimin për masën e sigurisë për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit, Shkëlqim Miri. Ky i fundit akuzohet për "korrupsion pasiv". Pas marrjes së relacionit, pritet të mblidhet KLD për të vendosur për shkarkimin ose jo të gjyqtarit të arrestuar. Ndërkaq, burime për "News 24" dhe "GSH" bëjnë me dije se KLD-ja do të mblidhet brenda kësaj jave. Pak ditë më parë, Gjykata për Krimet e Rënda caktoi masën e sigurisë "arrest me burg" për gjyqtarin Shkëlqim Miri. Ai hetohej që prej afro një viti nga prokuroria, pasi dyshohej se kishte favorizuar dhe i kishte marrë rryshet nga i dënuari Gentian Doda.

E zë masivi i gurëve,

humb jetën në minierë 20-vjeçari

BULQIZË - Një minator ka humbur jetën në mënyrë tragjike, teksa ishte duke punuar në minierën e Bulqizës. Ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme, ndërsa viktima është Eduard Dama, 20 vjeç, të cilit i ka rënë një masiv gurësh gjatë punës në zonën D të kësaj miniere. Goditja ka qenë fatale për Damën, i cili ka mbetur i vdekur në vend. Mësohet se ai ishte i siguruar dhe kishte disa kohë që punonte në minierë. Pas sinjalizimit për ngjarjen, policia ka shkuar në minierën e Bulqizës dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave.

DËSHMIA NË GJYQ/ "Zoto kërkonte 20% të shumës për tenderin e vezëve dhe bulmetit"

Korrupsioni me tenderët e ushqimeve, Iljaz Labi fundos ish-kreun e Burgjeve

"Biznesmeni më dha 20 mln lekë, ia dhashë Artur Zotos"

TIRANË

Korrupsioni me tenderët e ushqimeve në burgje ka përbalhur dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda ish-kreun e këtij institucioni me zëvendësin e tij, Iljaz Labi. Gjatë seancës gjyqësore, ish-nunri dy i Burgjeve, Labi deklaroi se biznesmeni Shemi Sinani i ka dhënë 20 milionë lekë tek një lokal tek "Blloku", të cilat duhet t'ia jepte Artur Zotos. "Artur Zoto me kërkoi të flisja me një biznesmen për tenderin e vezëve dhe bulmetit. Kërkonte 20% të shumës. Biznesmeni Shemi Sinani më dha 20 milionë lekë, të cilat ia dorëzova Artur Zotos në zyrë", - tha Iljaz Labi. Ndërkohë, ky i fundit u shpreh në dëshminë e tij se nuk e përjashton veten nga përgjegjësia, pasi edhe ai do të merrte pjesën e tij. "E bëra këtë punë, pasi edhe unë do të merrja pjesën time të parave. Kemi 20 vite që punojmë për këtë shtet dhe duhet të mbajmë përgjegjësinë dhe të pranojmë disa gjëra", pohoi Labi, i cili në këtë proces ka statusin e bashkëpunëtorit të drejtë-

sisë. Mbi dëshminë e tij, Prokuroria e Krimeve të Rënda arrestoi Artur Zoton, i cili akuzohet për korrupsion të zyrtarëve të lartë.

AKUZA NDAJ ISH-KREUT TË BURGJEVE

Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto, është arrestuar shkurtin e këtij viti, pasi akuzohet për korrupsion. Gjykata ka vendosur masën "arrest me burg" për ish-zyrtarin e vënë në pranga nga policia. Hetimet për të nisën kur u arrestua ish-zëvendësi i tij, Artur Zoto që u dorëhoq nga detyra disa muaj më parë, dyshohet se është i përfshirë në korrupsionin me tenderët e ushqimeve, për të cilat u arrestua zvdrejtori i Burgjeve, Iljaz Labi. Një seri bisedash të përgjuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda kanë ngjitur dyshime të forta për implikimin në aferat korrup-



Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto

tive në tenderët e ushqimit në burgje dhe të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Artur Zoto. Në dosjen hetimore ndodhen dhjetëra procesverbale me biseda të tran-

skriptuara, të cilat tregojnë se drejtori Zoto, tashmë i dorëhequr, ka qenë në dijeni të këtyre aferave korruptive dhe se Iljaz Labi nuk bënte asnjë hap pa mira-

timin e Zotos. Ndaj këtij të fundit prokuroria nuk lëshoi asnjë urdhër-arrest. Por dy ditë pas operacionit të arrestimit të zëvendësimit të tij, Iljaz Labi dhe katër biznesmenëve: Elidjan Laskaj, Ylber Kalaja, Shemi Sinani e Nexhmi Balla, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka dhënë dorëheqjen, duke ia justifikuar largimin ministrit të Drejtësisë, Manjani nëpërmjet një letre, ku i shkruante se ishin motivet personale dhe familjare të tij, që e çonin në largimin nga kjo detyrë. Por, në një seri bisedash të përgjuara, pasqyrohet dhe një bisedë mes biznesmenëve Nexhmi Balla dhe Elidjan Laskaj, ku Nexhmiu e pyet Elidjanin se çfarë kishte bërë. Nga ana tjetër, Elidjani i thotë se sa kishte dalë nga Drejtoria e Burgjeve. "Ai" i kishte thënë se do ta çonte lart dhe do t'i kthente një përgjigje.

Policia: Dy nga të kërkuarit, doganierë në Qafë-Botë

Bllokohet kamioni me televizorë dhe lavatriçe kontrabandë, shpallen në kërkim katër persona

SARANDË - Policia e Sarandës ka goditur një rast të veprimtarisë kriminale të kontrabandës, ndërsa ka shpallur në kërkim 4 persona, nga të cilët 2 doganierë. Pas një hetimi të nisur prej Departamentit të Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit, në bashkëpunim me Policinë Kufitare Sarandë, lidhur me parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale, trafikëve të ndryshme dhe kontrabandës, u sekuestrua një

sasi mallrash, të cilat hynin kontrabandë në kufirin shtetëror shqiptar prej Pikës së Kalimit Kufitar në Qafë-Botë. Konkretisht është sekuestruar mjeti kamion me targa AA 537 OF tip "Benz", me të cilin bëhej kalimi i mallrave në Shqipëri. Mësohet se në brendësi të kamionit janë sekuestruar nga policia në cilësinë e provës materiale rreth 140 thasë me veshje, 9 televizorë, si edhe sende shtëpiake si lavatriçe, dollapë, dyshekë, tapete etj. Si autor të kësaj

veprimtarie të kundërligjshme kanë rezultuar shtetasit: K.S., S.M., (shoferë të kamionit) dhe A.C. dhe E.D., (doganier në PKK Qafë-Botë), që kanë bashkëpunuar dhe kanë lejuar kalimin dhe futjen e këtyre mallrave pa i deklaruar në Pikën e Kalimit të Kufirit shqiptar. Të katërt shtetasit e përfshirë në këtë veprimtari të paligjshme janë shpallur në kërkim, pasi janë larguar në momentin kur kanë kuptuar se policia po zhvillonte një hetim dhe u ishte



Mallrat e sekuestruara

vënë në ndjekje. Sakaq, vijon puna për kapjen dhe ndalimin e personave të shpallur në kërkim si edhe për zbardhjen dhe dokumentimin ligjor për të tjera raste të veprimtarisë kriminale të kontrabandës. Materialet iu referuan prokurorisë për veprimtari "Kontrabanda me mallra të tjerë". **ar.su.**

Berisha: Doganierët e narkoshtetit të Noriegës u arratisën në Greqi

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, i cili thotë se pas kalimit të mallrave kontrabandë me kamion në pikën kufitare të Qafë-Botës, 2 doganierët dhe 2 shoferët janë arratisur në drejtim të Greqisë. Sipas denoncuesit, personi kryesor në këtë kontrabandë mallrash është përgjegjësi i turnit, Endri Dafa. "Doganierët e narkoshtetit të Noriegës kalojnë kamionin kontrabandë dhe arratisen në Greqi!", shkruan Sali Berisha në "Facebook", ndërsa publikoi edhe dy mesazhet e ardhura në adresë të tij. "Kamioni ka kaluar nga pika doganore Qafë-Botë. Personi kryesor në këtë mega-kontrabandë që ka kohë që vazhdon është përgjegjësi i turnit Endri Dafa, i cili ka një çështje ende të pambyllur në Prokurorinë e Fierit me skandalin e naftës, që është bërë publike nga "crinwaxhans", thuhet në njërin prej mesazheve.



Sali Berisha

Përfaqësuesit e sindikatave: Media të jetë më bashkëpunuese dhe më denoncuese

Përfaqësuesi i "EU OSH Agency": T' i jepet rëndësi dialogut social në zgjidhjen e problemeve

Voltiza Duro

Në ditën e dytë të trajnimit mbi kushtet dhe mbrojtjen në punë, Qendra Shqiptare e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në bashkëpunim me partnerët europianë dhe sindikatat diskutuan mbi rolin e medias. Në tryezën e rrumbullakët, përfaqësues nga Sindikatat e Pavarura të Shqipërisë vendosën në fokus lirinë e medias në vendin tonë. Ata kërkuan më shumë bashkëpunim e dialog me "pushtetin e katërt" për të bërë publike e për të ngritur zërin për problematikat që hasin sindikatat. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Tsvetomir Tsanev, përfaqësues i Agjencisë Europiane të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë theksoi se misioni i tyre është shkëmbimi i eksperiencave dhe sheshimi i problematikave për vendet



Tsvetomir Tsanev, përfaqësues i Agjencisë Europiane të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

kandidate në BE, përfshirë edhe Shqipërinë.

Cili është misioni i ardhjes suaj në Shqipëri dhe pjesëmarrjes në këtë trajnim?

Unë jam projektmenaxher i programit të Agjencisë "EU OSH Agency" për vendet kandidatë dhe potencial-kandidate për Bashkimin Europian. Misioni i ardhjes sime këtu, së bashku me kolegun, Tim Trigenca është mbështetja e trajnimit, të organizuar nga kolegët tanë të Qendrës Sh-

qiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në punë. Jemi këtu për të shkëmbyer eksperiencat lidhur me këtë çështje.

Çfarë ofron Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë?

Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ofron shpërndarje informacioni, kërkime dhe promovim.

Cila është fushata juaj?

Qëllimi ynë është prezantimi i fushatës "Vende pune të shëndetshme për të gjitha

BOJAN KORDALOV

"Media nuk duhet të raportojë vetëm kur ndodh një problem, por duhet të jetë çdo ditë në kontakt me qytetarët. Media është e ndikuar nga politika apo dhe nga faktorë të tjerë, por duhet të kuptojë që fokusi i saj kryesor duhet të jenë qytetarët e problemet që prekin këta të fundit", - u shpreh Bojan Kordalov, specialist i mediave sociale.



moshat", e cila është një fushatë europiane. Gjithashtu, dëshirojmë të takojmë aktorët kryesorë që operojnë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë në Shqipëri, organizatat profesionale, inspektoratin e punës dhe partnerët socialë.

KOÇO JANI

"Problematika në vendet e punës është e gjithanshme në lidhje me sigurinë dhe shëndetin. Që të zbatohet ligji, duhet të përmblen disa komponentë, siç është krijimi i kështillave të sigurisë dhe shëndetit brenda ndërmarrjeve", - tha për "GSH", Koço Jani, sekretar organizativ pranë Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.



Sa i rëndësishëm është dialogu mes këtyre aktorëve për mbarevajtjen e procesit?

Shumë i rëndësishëm! Dialogu social ka një peshë të

Nis rikualifikimi

i bllokut të banimit

në Njësinë 8

Blloku i banimit në zonën e ish-"Frigoriferit" në Njësinë 8, po shndërrohet në një nga lagjet model të kryeqytetit. Bashkia e Tiranës ka nisur të zbatojë një tjetër projekt të madh transformues, i cili prek një hapësirë prej 13.2 ha dhe nga ku përfitojnë rreth 8 mijë banorë, si dhe bizneset që operojnë aty. Në nisjen e punimeve mori pjesë kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe deputeti i PS, Ervin Bushati, të cilët vlerësuan se falë këtij investimi, i jepet përgjigje një kërkesë të përhershme të banorëve të zonës.

madhe dhe luan një rol të rëndësishëm për mbarevajtjen e gjithë procesit në mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet që atyre u ofrohen në vendin e punës.

Cilat janë disa nga problemet që kenel vënë re në Shqipëri lidhur me këtë çështje?

Së pari, dua të theksoj se ne nuk kemi ardhur për të verifikuar problemet. Cfarë-dolloj problemi që të ketë Shqipëria, jam i sigurt që me informacionin dhe me shkëmbimin e eksperiencave midis ekspertëve, këto probleme do të përmirësohen dhe do të sheshohen.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA

CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement
Project ID No. 8521

Assignment Title: Advisory Support for Validation of Services provided with Improved Front Office

Ref. No. ALB-8521/CS/CQ/3.10.02

As part of the reform, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA), was established in October 2014 to manage the centralized public service delivery to the citizens. Its expanded mandate includes the implementation of the separation of the front office (FO) from the back office (BO) in all central institutions, aiming to improve access to public services as well as the quality of service delivery through establishing of service, based on a customer-care culture.

To implement the program, the Government of Albania has received financing from the World Bank. The Project Management Unit, the Ministry of Innovation and Public Administration (MIPA) as the lead implementation agency supported by the Delivery Unit at the Prime Minister's Office, and ADISA, as beneficiary agency under the ISDA program, manages the technical aspects of the activities.

Under the second pillar, the program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model, through establishing integrated centers/ one-stop shops. ADISA is currently managing one front office at IPRO in Tirana and four One Stop Shops in four different cities. These new facilities offer citizens and businesses improved physical access to public services, with improved customer service culture and standards regarding the delivery, aiming for reduced transactions time and a reduction in petty corruption.

The results of key activities are linked to Disbursement Linked Indicator (DLI#3) - Services offered with improved customer service front office interface - that will be verified/ validated through a third party. For this purpose, ADISA is seeking a consulting company (hereafter referred to as the Consultant) to conduct such verification exercise. The Consultant is expected to develop the methodology, conduct data collection and analysis, and prepare the findings/verification/ certification report.

The scope of work is to conduct an in-depth assessment to measure (a) improved access to services and (b) improved quality of services, as measured by professionalism, courtesy of staff, queue management and waiting times; easiness of application process, standard application forms, personnel dressing and presentation, information desk, complaint management, etc.

The key tasks and main activities the Consultant is expected to carry out include, but not limited to, the following:

1. Design a comprehensive and clear methodology proposing multiple method approach to gather the needed information (both qualitative and quantitative), in order to reach all target groups. Some potential data sources could include, but might not be limited to, exits surveys, direct observations, focus groups, etc. Secondary data would be useful to use as well to complement the primary ones.

2. Design the instruments for data collection to make sure all necessary data on access, customer service, corruption, etc., are collected. The data collection instruments should be agreed upon with the Client/ ADISA before implementation.

3. Implement the agreed methodology to collect the necessary data. The data collection should be carried in multiple location (all FO/OSSH) to allow also for comparisons of the number of services available at each location, etc.

4. Perform data analysis and produce the verification report.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- At least 10 (ten) years of professional consulting experience with a focus on assessment, in-depth review of customer services at front offices operation in public or private sector.
- Proven experience in designing and implementing research methodology, including both qualitative and quantitative approaches.
- Previous experience in World Bank funded projects and/or DLI verification will be an advantage.
- Fluency in English language, spoken and written (for key members of the team); and
- Availability of staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

The Team Leader /Survey Researcher shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree and demonstrated experience in economics, business management, development economics, or related fields;
- (b) Minimum of ten (10) years professional experience in designing and implementing of assessment related to customer service in public or private sector as well as proven experience as team leader;
- (c) Proven experience in carrying out/ leading such assignments/ third party verification, working for large institutional donor supported projects.

The Fieldwork Coordinator, who is expected to administer the foreseen field activities, and provide technical oversight and guidance to the field team to ensure collection of quality data, shall possess the following qualifications:

- (a) Master's degree or demonstrated experience in economics, business management, or related fields;
- (b) Minimum of five (5) years professional experience in managing field activities and ensuring compliance with the survey methodology at all levels of data collection;
- (c) Very good understanding of customer service in public or private sector;

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 30, 2017, at 12.00 local time

Project Management Unit Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shëptëria e oficerave, Kati V-të Tirana, Albania
E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al; and
ccsdprojectalbania@gmail.com

DOSSIER

Letrat e viteve 1919-1920 mes Mustafa Krujës e Luigj Gurakuqit shpalosin Shqipërinë e kohës me probleme financiare e politike, shtuar kësaj edhe rrezikun e copëtimit të vendit

LETRAT PERSONALE

Mustafa Kruja, Luigj Gurakuqit: Qeveria e ka falimentin në derë

Shtëpia Botuese OMSCA-1 nxori në qarkullim librin "KUVENDI LETRASH ME MIQTË". Vëll. V, me autor MUSTAFA MERLIKA - KRUIJA ME e Pater Paulin Margjokaj, OFM. Letra e parë e këtij vëllimi mban datën 6 dhjetor 1919 dhe i drejtohet Luigj Gurakuqit dhe letra e fundit mban datën 29 korrik 1958. Letra që i dërgon Gurakuqit ka rreth 3700 fjalë dhe na jep informata mbi gjendjen e Shqipërisë në vitin 1919. Një pjesë e kësaj letre na kujton gjendjen e sotme në Shqipëri. Letrat e Krujës janë burime historike të dorës së parë. Këto letra kanë cilësi të veçantë, sepse janë personale, intime, dhe me plot detaje. Të shkruara para 100 vitesh i mundësojnë lexuesit njohjen me realitetin e kohës, nga sherrat politike te situatat ekonomike.

LETËR - KËMBIM
MUSTAFA KRUIJA - LUIGJ GURAKUQI
Confidentielle

Durrës, 6 dhjetor 1919
Fort i dashuni Luigj,
Nuk po diç se nga t'a kap e ku t'a mbaroj! Nji send diç veç: qi s'kam për të mundun me të shkërrumë as të dhettën e atyne qi kam në zëmër e në mënd: se koha tepër e ngushtë e punët shumë të gjata. Kopien e letres raportë që kishit pasë dërgue në Helvetië e këndova, ashtu natyrisht edhe dokumentat tjerë qi vijshin bashkë me të.
A thue kishte me qënë nevoja me t'a përmëndun, përpara se me hymë n'argumentin vetë, se kjo është nji letër thjeshtë e veçantë qi nuk i ep të drejtë kurrkui me diçtun se ç'thotë, përposë atyne, natyrisht, qi mundemi ti edhe un me i futun në zëmërat t'ona?
Hapi sytë pra tashti mirë! Postën t'uej qi pruni Rexhepi e mora un dhe i çova në Këshill n'atë ças kur ky do të çiljed edhe lajmova mbi t'ardhmen e Rexhepit. Lajmi nuk u prit me atë entuziazëm qi ndiejsha un. Por ç'ka? Filllova me këndue raportën, letrën përsjellse përpara. Këshilli ishte i përëbamë prej Mufid Beut, Fejzi Beut, Pogës e meje. Pikë së pari filluen ironitë nga ç'do anë. "do fjalë qi kishte karakter këshilli pritej me nji të qeshun nën mustaqe e me nji lëvizje mërzie e shdurimi. Nuk mbaj mënd se në ç'pikë kishim arrijtun kur njëri prej nesh, Fejzi Beu, kërkoi ndjesë me dalë jashtë, se s'po mund të duronem me ndëgjumë më!!!
Duket se ti jo vetëm në sy, por

1919, Kruja: Jam ministër po si ta shpëtoj nderin tim nga fundi i qeverisë?

Gurakuqi: Nuk kam frikë nga plumbat, por jam i sëmurë e nuk dua të ketë dyshime...



Në foto:
Mustafa Merlika - Kruja

edhe me mijna kilometrash larg s'e ke guxim in me i a prishë qeifin kuj as kur është nevoja për interes të Shqipërisë! Nuk do të këshillohej nji punë e tillë nga ana e kryetarit të Dërgatës gati si nji mëndim personal, por drejt për së drejti nga ana e njeriut kompetent do të disponohej me nji shkresë a Z-it Poga ase, ma mirë, Kryetarisë.
Si të thashë pra tashti mbildhemi ditë për ditë dhe, natyrisht, ma shumë bëjmë fjalë se punë. Fjalët qi fliten vetëm 10% mundem i shërbymë argumentit e 90% janë të kota. Shumë herë në mest të bisedimit të nji argumenti me rëndësi i a nisim gjyqit e, kur mbarojmë gjyqin ka humbun më fija e lëshit dhe duhet me e fillue nga e para bisedën! Nuk jemi mësumë, nuk dijme pastaj mjerisht as me kuvëndue këthjellhtë, ftil-

lueshëm e me rregull e, edhe nga ky shkak na shkon nji pjesë e madhe e kohës kot. Arrangat e z-it Poga më të shumën nuk i bien as për kopsht argumentit mbi të cilin silltet biseda. Ai në karrierën e vet është më i madhi juriskonsult roman, por nuk i mjafton kjo nderë e madhe, asht edhe nji enciklopedi e gjallë, nji bibliotekë shëtitëse! Këto janë të vështirat qi lejne prej trunit të tij, se kurrëgjë e as nji fjalë s'i pëlqen, çdo qi t'i vëshë përpara, çdo fjalë qi t'i thuesh do të gjëjë qortimet e kundërshtimet e atij gati.
Të vështira këso kategorie nuk janë të pakta as nga ana e Fejzi Beut. Por t'atija s'lejnë si të Pogës nga idiotia, por nga se është shumë i lidhun me interesën. Këthj nuk i mënimhem edhe aqë, por vetëm i qaj hallin Shqipërisë, e ndoshta dhe atij vetë. Fejzi Beu, i mësumë, si

ç'e din ti vetë, me jetue me mjetet më të gjanat e të mirat, me të vetmin fitim të nëpunësisë, s'mund të dënohet sod aqë rreptas pse mendon para çdo sëndi, po, edhe para atdheut rrogën. Kjo nevojë e bën me veprumë me sa faqe të duesh, me u bëmë i mbrëndshëm e i dashëm edhe me tradhtorët e sodshëm qi duken a munden me pasë fuqi a mënyrë me rrëzue qeverinë a qi munden me zënë nesër atë vënd vetë. Kjo nevojë prap e shtyn në nji skllavn kundrejt politikës italiane, këshu qi në çdo bisedim për ndonji hap energjik te italianët gjën kundërshtimet e tij t'arsyeshme e të paarsyeshme. Po ajo nevojë e çon mjerisht me gjujtë, kur i sheh gjasën, ndonji peshk n'uj të turbullt, dhe prandej i pëlqen e pra mudohej qi uji të rrijë gjithmonë i turbullt, pa u kul-lue kurrë!

Z. Poga edhe mos pandeh se i lën gjë mangut Fejzi Beut në frikën e humbjes s'interesës e të selisë.

Sami Beun për mënd e dije e nje vetë, s'kam se ç'të them. Po të dëftë vetëm qi nji të metë morale qi shokët e sipërtregumë e kanë për mjet, ky nemose e ka për fund: "ambition et manie de passer pour le meilleur patriote".¹ Kjo e fundit, për fat të keq, e ka shtymë dhe e shtyn shumë herë me fymë edhe krejt shokët e vet.

Në bisedimet e Këshillit ai qi flet më pa arriere - pensëe² është Mufid Beu. Faji i këtij asht më shumë i shkakumë prej tjerësh se i vetishëm. E ky asht mosbesimi qi ka hymë ndër mjetit tij e kombtarëve. S'ka kombtar qi të jetë i besueshëm e i dashëm te Mufid Beu, në qoftë se ky nuk do të ketë prova të mëdhaja fort për të. Por këtë mosbesim, si thashë, e kanë shkaktumë vetë kombtarët qysh më 1913 me kritikak e kafavejt e jo Mufid Beu.

Nji qeveri e këthillë "multicolore" e pa asnji homogeni, e si do të mundte vallë me i imponue besim nji populli aqë skeptik e si kishte me qënë e zója me u bëmë ballë kundërshtimevet e intrigavejt t'anniqvet të mbrëndshëm e të jashtëm e sa të vështirave tjera qi vetë natyra e sendevejt i pjell e na i qet përpara? Sod populli i ynë më dypika kryesore interesohet me gjithë shpirt: qetësi e Shqipni. Kur them populli due të kuptoj zënin botor të pjesës së mitun e të nder-shme. Deri sod, për fat të keq,



Në foto:
Kopertina e librit

s'kemi qënë të zotnit me i u përgjegjun as njëns nga ato dypika. Qetësia gjindet në më të vajtueshmin shtat qi mund të jetë. Ndër njëqind vrasa a kapen a s'kapen dy fajtorë. E pse u kapkan ç'duhet? Un qi jam ministër s'kam ndie deri tash të jetë dënumë kush as për vdekë as me ndonji burgim të gjatë! Sa për pikën e dytë, natyrisht, interesohen ma tepër ata qi kuptojnë pak a shumë ndonji sënd. Ata duen të dijnë ç'po bëhet e ku jemi. Na as këtë, aq "simple" tue qënë, s'kemi qënë të zotnit me e bëmë. Dërgata Bumçi s'ka dyshim se është tregue më aktive se Dërgata Turhan në të dhënë lajme qeverisë. Por qeveria s'ka qënë e zója me i shtypë e përhap ato në popull. Po përse? Më vjen turp me e thanë, por është thjeshtë e vërtetë, se përveç meje tjetër kush as nuk interesohet, as nuk ishte i zoti t'i bëmë. Por sa mund të bëjë nji frymë e vetme? Përveç kësaj, për mos me zgjue e shkaktue usinë e smirën e shokvet duhet qi të sillem me masë të madhe kur do të përzhem në punët e tyne.

Pra sa do i urtë e me ndiesi të mira t'ishte ky popull domosdo do t'ishte mërzitun prej nji qeverie të këthillë. Shtu pastaj edhe intrigat qi s'prajnë e s'mëjnë ndonji herë në Shqipni. Edhe Italianët s'po e lënë mëtet fare pjesën qi u përket nga intrigat e hueja në vëndit

Merlika - Kruja

Luigj Gurakuqi
Lazër Shantoja
Anton Paluca
Miftar Spahija
Hamdi Oruçi
Preng Gruda
Fiqret Juka
Agim Karagozi
Reshat Agaj
Të ndryshëm

ND LETRASH
ME MIQTË

OMSCA-1

V

← t'onë, Frengj, Serb e Grekë
má po dihen. Por rolin má të
madhin e të bukurin në shqenën
e intrigavet të hueja e ka bënë e
ásh t'ue e bãmë Filipis.

Tirana ásh bãmë qendra e in-
trigavet kombtare e ndërkombtare!
Filipis fort shpesh e viziton këtë
qytet të mallkumë. Quartier
Général-i Kryqit të Kuq (!) ameri-
kan aty ásh. Me gjithë qi ásh një
punë e dorës së dytë në këtë kapit-
ull, mbas si i përket dikasterit
t'and po të dëftë qi ky Kryq i shjëjt
(!) ka hapun edhe një shkollë në Ti-

ranë, një shkollë fillore, pa pasun
nevojë as me e lajmue fare
qeverinë! Kush ásh burrë me u
dalë në frymë pastaj patriotvet?
Italianët kishin hekun dorë nga të
hapunit shkolla në Shqipni. Por
efekti i kërkimit të mandatës
amerikane për fitimin e mandatës
italiane, pa dyshim ka me e dëftue
veten edhe në çásh t'jen e shkoll-
lavet. Duhet t'a dijsh se Ameri-
kanët me Filipsin e Filipsi me de
Fortou-hin munden me u quejtin
në trup në Shqipni. Në krye të
Kryqit të Kuq amerikan ásh një
kolonel shumë i hollë e i zoti.

Ajo qi e bán sod fare kritike situ-
uatën e mbrëndëshme e pozicion-
imin e qeverisë, ásh çásh t'ja finan-
ciare. E kemi "fallimento"-n në
derë të shtëpisë. Shpenzimevet të
Shtetit mbarë do t'u përgjigjen
vetëm të dhetat e tri prefekturave

NE JEMI PROFETË
"Dihet mirë se Bumçi,
Fishta, Mustafaj, un e shumë
të tjerë nuk ua kemi pasun
kurrë besën Shqevet edhe
faktet na nxuerën profetë;
por këtë të vërtetë nuk e
kanë kuptuem akoma të
gjithë e, sikur të kisha
ardhun në Shkodër n'ato
ditë kur nisi lufta, do të
kishin thënë se erdha për t'i
shtuem dr zjarrit", shkruan
Gurakuqi.

(Durrës, Elbasan, Berat) e dogana
e Durrësit dhe as një burim tjetër:
'munden me mbajton këto? Janë
prishë për nëpunsit e gjindarmët
e prefekturës së Shkodrës deri so
treqind mijë franga pa u marrë as
një dhëtesh nga ajo anë. Të dhetat
e një vëndi nuk po mjaftojnë as për
rogët e veta e deri Tirana ka fillue
qysh tashti me tërheqë të holla nga
qendra, d.m.th. nga dogana! Fejzi
Beut i ka pëlqye me i administrue
financat e Shqipnisë me dy a
tre sekretarë qi ka sjellë prej
Shkodre e pra s'ka mundun
kurrë me na vue përpara një
pasqyrë të saktë të situatës
financiare. Lene qi ligjet nuk
dihet ndër ne se kujt i thonë.

Përpara gjithë këtyne të
vështirave, gati i paralizuem
kryekëput e i pazoti me çue
në vend e me vumë në vep-
rim as 10% të dëshiravet e
mendimevet qi kam për
shpëtimin nga situata kritike
në të cilën gjindemi, un
shumë herë jam kujtue se si
me shpëtue veten e sidomos
nderën t'ëme nga një fund
"inevitament" i vaj-
tueshëm i qeverisë s'onë.
Natyrisht përpara konditave
të këtilla nuk do të kishite
tjetër udhë për mue përveçse
me u tërhequn. Me gjithë qi
nuk m'ásh mbushun mënda-
ja edhe premas, të më kishite
dalë përpara ndonji shkak
i arsyeshëm në vetvete,
ndoshta nuk do të kisha ndër-
jun má saktë. Në një vënd
kaqë të vogël ku gjindemi e
ndër një popull kaqë të
padijshëm duhet të bájsh gati
dy palë arsylene para se me u
hekun: ato të mbrëndëshmet
e të vërtetat dhe ato të jashtë-
tëmet, të përfaqëshmet.

Kaqë, sa me të shkelë për
me mos t'ardhun keq as
çudë, në qoftë se një ditë
t'afërme kam me të shkruie jo
má si shok, por vetëm si mik
i yt besnik e i përjetëshëm

Plaçkat e tuja qi kanë qënë te
Çile Serreqi-Baba (e shoqja e një
farë Kol Babe tashti) i mora me një
mijë belá. Më kërkonte tridhët
napolona ar qirá! Por má u bá si u
bá e ajo veçse qiti për fushë faqen
e zezë se má në fund u shtrëngue
me i dhánë pa asnjë pare. I kam
marrë qe tashti vonë ka një një
muj. Këto janë: 1) armadio, 2) co-
modino, 3) një qylym i madh, 4) ca
perde basmje, 5) gjashtë selia, 6) e
dokumentat e arsimit. Të gjitha i
kishin pasë përdorue e vjetruie.
Edhe un po s'jam tue i lánë me
ndejun kot! E kështu kur të vijsh
të shohim se ç'do të gjësh në to!...
Besa po due me qeshë se un po t'i
ruej, por më vjen keq se t'i kishin
pasë bãmë mjerisht për faqe të
zeze. Janë edhe dy perde kadifje në
një vënd tjetër e do sexhade muri
e s'dij ç'tjetër má te Stef Kaçulini.

Këtij s'do t'i a luej se të ka edhe
vetë mik e ásh i interesuem me i
pasë në kujdes edhe ai sa un.

Një letër qi më pat çue Emzot
Bumçi për një shkodran, mbas si
ky kishte pasë shkue në Vjenë për
në Shkollë, i a dërgova të vëllait,
Zefit, në Lesh, qi t'i a çojë fëmijës
së tij apo kujt t'i a marrë mënda-
ja.

Tash po i nap fund tue marrë
ngrykë ty, t'Emzot edhe P.
Gjergjin. Shumë të fala m'u thuej
edhe Lefit, Mehdi Beut e Berattit
edhe kujt do qi'ta dijsh ti se i pret
me zëmër. Sido qi e mbylla me të
përhëndetuna, tue çue për
mëndsh ëmnat e atyshëm, m'u
kujtue edhe urata Bonati. Po due
me u lajmue, në mos e dini, se
edhe në Shkodër qënka një Berat-
i të cilin e paskan italianët të
tynin, d.m.th....

Kish t'a dij Sulejman Delvina
aty ásh edhe? E Shan Tepelena?

I yti me gjithë zëmër
Mustafa Kruja (firma)
A.Q.Sh. Fashikulli 34 Dosja 35
Fletët 336 - 345

Rexhep Bej Mitrovicën ju a
nisëm si "corriere" për shumë
punë qi ka me ju a shkoqitë me
gojë. Ti këtë e njeh mirë. Siç e din,
ásh njeri i ndershëm e patriot (jo
nga patriotët e Midhatit), i zoti me
i gjykue punët má hollë e objek-
tivisht se shumë shokë të vet...

Sikurse t'a pata thánë edhe má
nalt, me "Komitetin e Kosovës"
mundesh me kuptuem një sënd
ma të gjánë: një parti, të pa ndonji
programë të shkrueme e të caktu-
eme, por qi pak a shumë influen-
con mbi qarkun "intelektual" të
Shqipnis. Në Shkodër mundeshim
me pamun qëndrën e kryet e kësaj
partie me personat e Hoxha Kadri-
ut, Salihut t'onë, Bedriut, Sejfiut
dhe Bajram Fevziut. Rexhep Beu
ásh si me thánë përfaqgues i tynë
këtu në Durrës, në kryeqytet (!) e
gjindet në marredhëna të
përditëshme e intime me mue. Un
i a kam shkoqitun të tána vep-
rimet t'ona të përjashtme e të
përmbrëndëshme edhe ai mue ato
të partis a Komitetit të tynë. Pika

PËRGJIGJA E GURAKUQIT
Të dashun miq e vllazën

Z.Z. Kel Kodheli e Mustafë Kru-
ja

në Shkodër

Letrat t'ueja më 26 të mujit qi
shkoi mbarojnë të dyja në një
mënyrë, domethënë, tue më
treguem zëmrimin t'uej për
vonesën t'ime në këto ana. Më vjen
keq për helmimin qi keni marrë ju
e jo për fjalët qi më thoni, pse e dij
se ashprimi i fjalvet t'ueja rrjedh
prej dashunis qi keni për mue e
prej dëshirit qi keni qi t'i shërbe-
jmë së bashkut atdheut. Ju pastaj
nuk i dini as gjëndjen e shëndetit
t'im as mendimet e mija mbi rre-
thanat politike të sotshme, sikur
dhe un nuk mund t'i dij aqë mirë
sa ju nevojat e atdheut të tashme,
mbasi ju gjendeni në vend e mund
t'i vështroni e mund t'i peshoni má
mirë se un prej së largu. Ju fola për
shëndetin por mos besoni se jam
tue vdekun; ndihem shumë má
mirë, po nuk mund të thom edhe
qi i vesh mundosh tynë fare; po
prapë do të ju shtoj se nuk
ásh vetëm shkak i shëndet-
etit qi më mban akoma këtu.

Un do të nisem së këtejmi
posá të mbarojnë, në një
mënyrë a në një tjetër,
bisedimet italo - jugosllave.
Dihet mirë se këto bisedime do
të mbyllen për së shpejt dhe,
ja nuk do të nxjerrin gjá në
dritë e atëherë do t'ashprohet
konflikti, ja do të pjellin një
marrëveshje me të cilën do të
marrë fund edhe çashtja sh-
qiptare. Mbetet edhe një
zgjidhje e tretë: marrëveshja
italo - jugosllave tue mbetun
e varun çashtja e Shqipnis.

Sido qi t'u dalë fundi kë-
tyne bisedimeve, Shqipnija,
në mbarim të tynë, do të zájë
domosdo një udhë të re, dhe
atëherë do të ketë nevojë për
ndihmën e të gjithë sh-
qiptarvet e, ndofta, edhe për
t'imen, në qoftë se jam akoma
i zoti t'i bá ndonji shër-
bim.

Deri më sot nuk kam
dashun të vij, jo pse kam pa-
sun frikë nga plumbi i
Shqaut, po nga shkak i shëndet-
etit e për të mos i dhánë sh-
kak askujt qi të formojë dy-
shime mbi mue.

Dihet mirë se Bumçi, Fishta,
Mustafaj, un e shumë të
tjerë nuk ua kemi pasun kur-
rë besën Shqevet edhe faktet
na nxuerën profetë; por këtë
të vërtetë nuk e kanë kuptu-
em akoma të gjithë e, sikur të
kisha ardhun në Shkodër
n'ato ditë kur nisi lufta, do të

kishin thënë se erdha për t'i shtu-
em dr zjarrit. Ndryshe do të kish-
te qënë puna po të kisha ndodhun
aty; atëherë më duhej me e bãmun
plotësisht detyrën t'ime. A nuk
kam të drejtë?

Mos besoni se këtu jam tue e
humbun kohën: po merrem me gi-
uhën shqipe; po punoj me dëshirë
e po më kënaqet shpirti.

Po ju thom pra edhe njëherë se,
ndonse më vjen keq qi ju dhashë
shkak të zemrohëni, prapë nuk më
duket t'i kem mungue detyrës për-
para atdheut. Më vjen keq má fort
në qoftë se nuk do të gjëj Mustafën
në Shkodër:

**Ju puth me mall të dy; shëndet
atyne qi më kujtojnë.**

I Ueji

Luigj

(A.Q.SH.Fondi Kolë Marubi,
Dosja 20)



Në foto:
Luigj Gurakuqi

MBI TOPTANËT

Marrëveshja ime me Rexhepin
e Eshrefin e ka ndërrue 60 % sjell-
jen e Atdhetarvet, por kësaj mun-
demi me i shtue edhe një a 20% për
dobinë t'onë, të cilën do t'u a dijme
për ndërë Toptanvet. Kryengritja
e Shijakut u a dëftue fort këthjell-
tas Atdhetarvet se kush kishite me
përfitue nga një ndryshim qeverie
e ç'kishin me rrjedhun prej një
aso pune. Kështu qi sod, atdhetarët
e vërtetë me vullnet të mirë kanë
mbetun vetëm kritikues, por
kundër rrezimit të qeverisë e ndër-
rimit të Dërgatës, d.m.th. kundër
një fikjes s'atdhet, në dash!

Sa për tradhtarët (Toptanasit),
atyne jemi tue u ndëjun me dr
dhambvet e me kobure në dorë, sa
me u a kufinuem të ligat. Por s'jemi
e s'kemi për të qënë, si duket, të
zotnit për me i shtypun!

má me rëndësi qi i vën ata në një
farë kundërshtimi me neve ásh
një optimizëm i çuditshëm qi kanë
për simpatinë e interesimin e
Amerikës dhe t'Ingiltërrës për
çashtjen t'onë. Për me krijuem
këtë optimizëm rrens e fort të
dámshëm kanë shërbyem letrat e
Fuadit dhe fjalët (propagandat) e
Filipisit. Shpresoj se tashti Rexhe-
pi ka me u lajmue me e ndriçuem
mirë në Paris, e kur të kthehet ka
me pasun mëndime má
realiste. Ase nëse ka ndërruem
ndonji sënd mbasi kam dalë un
prej Parisi, at'herë ka me qënë "un
altro paio di maniche".

Ju marr n'grykë të gjithvet si
vëllazën të dashun e ty po të puth
në të dyja faqet.

I yti me zëmër
Mustafa Kruja (firma)
A.Q.SH. F.34 D.35 Fl. 334 - 335

BOTIMET E REJA/ PANAIRI

LIBRAT E RINJ

Nga Gunter Grass, te Salman Rushdie, Ishiguro e Aleksandër Mexsi

Fatmira Nikolli

Bota e librit në Shqipëri vuan. Vuan nga përkthimi shkëlqës dhe shko, vuan nga librat e dobët, vuan nga mungesa e lexuesve, vuan nga çmimet e larta, vuan nga mungesa e financave, vuan për vëmendje, vuan edhe për librofili. Por bota e librit është edhe panairi i çelur dje, mes gjithë këtyre vuajtjeve është një festë libri, e mes shumë dobësive ka botime të mira, përkthime të mira, autorë të mirë në zë, nobelistë, autorë shqiptarë, studime, libra për fëmijë e të rritur. Për të gjitha këto arsye dhe për librin, si portë drejt të tjera botësh, panairi është një festë që nuk duhet humbur. "GSH" iu është drejtuar disa shtëpive botuese për të marrë prej tyre, titujt e rinj që vijjnë në panair.

ONUFRI

"Onufri" ka në panair monografinë e Aleksandër Meksit, "Shën Kollit, Mesopotam, Sarandë", një libër studimor mbi një prej kishave më të rëndësishme në Shqipëri. Profesor Mexsi i ka kushtuar tërë jetën studimit të monumenteve të kultit në vendin tonë dhe është një prej të paktëve njohës deri në detaje.

Nga e njëjta shtëpi botuese vjen edhe një autor i ri, por mjaft i talentuar, Saimir Muzhaka, me romanin e tij të parë nën titullin "Qyteti plak". Ky libër u cilësova në miri nga Ministria e Kulturës, e cila mbështet autorët sh-

qiptarë, përmes projektit "Fondi në mbështetje të krijimtarisë letrare". Në Panairin e Librit Tiranë, prezantohet edhe vëllimi i ri poetik i Skënder Buçpapaj "Jubileu i shiut të çmendur" ndërkohë, si gjithnjë Onufri paraqet gjithë korpusin letrar të Ismail Kadarese.

BOTIMET IDK

Vjen në shqip fituesi i çmimit "Nobel" Günter Grass me romanin "Me hapin e gaforres", përkthyer nga Afrim Koçi. Është romani i fundit që ai shkroi dhe, padyshim, një prej romaneve më të bujshëm të letërsisë gjermane. Në fokus është sërish historia e trazuar e Gjermanisë. Por jo më ajo e fajit gjerman. Romani ka në qendër mbytnjen në detin Baltik të anijes "Wilhelm Gustloff", me 9000 refugjatë gjermanë, kryesisht gra dhe fëmijë. Bëhet fjalë për katastrofën më të madhe të historisë detare, ku humbën katër herë më shumë jetë njerëzore se sa në rastin e Titanicut, që për shumë dekada me radhë askush s'e përmendte. "Me hapin e gaforres", mesazhi i Gunter Grass-it është se të gjithë gjermanët, por sidomos e majta liberale, duhet të tregohen më të ndjeshëm jo vetëm ndaj krimeve të kryera, por dhe ndaj viktimave të historisë gjermane.

BOTIMET PEGI

Ka jo pak titujt të rinj, për të gjitha moshat. Pegi sjell "Histori

arratie dhe qëndrese", të Elena Ferrantes, vëllimi i tretë i sagës së "Mikeshës Gjennale".

"Posta", Charles Bukowski: libri i parë i tij, një gur themelor në botëkuptimin e këtij shkrimtari kontrovers. "Posta", romani i parë i Charles Bukowski-t, një ish-nëpunësi të rëndomtë poste, u botua më 1971 dhe tronditi fort Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Siç do të ndodhte për pothuajse gjithë prozën e tij, protagonistit është alteregoja legjendare e Bukowski-t, Henri Çinaski. Gjithashtu, në panair është edhe një version i redaktuar i librit të tij ikonik "Femrat".

"Dhunë e dhunti" e Enit Karafililit, është romani shqiptar i panairit. Është një histori emigrantësh shqiptarë në ShBA, plot zemërtjerje, ëndrra dhe romantizëm. Të lidhur ngushtë, jo vetëm përmes kapilarëve të hollë të gjakut, fëmijërisë dhe ëndrrave të tyre, përjetësisht të pandashme, mes tyre futet shpirti i një gruaje. Tesa, "e marra mish e thua e të vëlait", do të tronditë marrëdhënien e tyre, duke i larguar, por edhe duke i ngërthyer keqas me njëri-tjetrin.

"Zemra vërtitëse" e Donal Ryan përkthyer nga Sokol Çunga është një roman me shumë zëra mbi efektet e një krize ekonomike në një komunitet të vogël, duket i shkruar enkas për Shqipërinë, me

gjithë se ngjarjet ndodhin në Irlandë. "Zemra vërtitëse" ka tërhequr vëmendjen e kritikës dhe ka fituar The Guardian First Book Award, (2013) çmimin "Libri i Vitit" në Çmimet e Librit Irlandez; ka qenë konkurrent në Dublin IMPAC Literary Award dhe në Man Booker Prize (2013). Në vitin 2015, fitoi Çmimin European për Letërsinë.

Një rrëfenjë me një thjeshtësi mashtruese do të zbulojë pak nga pak një thellësi emocionale të jashtëzakonshme: një nga veprat më të mprehta të Kazuo Ishiguros. Në panair, do të jetë ribotimi i përmirësuar i romanit "Mos më lër të shkoj", të Kazuo Ishiguros përkthyer nga Rudi Erebara, Nobelistit të saposhpallur, ndërkohë që Pegi ka marrë të drejtat e autorit edhe për 4 vepra të tjera të këtij nobelisti.

ALBAS

"Nëse ty të ka dalë nga mendja, zotëri i nderuar, po ta kujtoj unë: jam jot shoqe." Kështu hapet letra që Vanda i shkruan të shoqit, i cili është larguar nga shtëpia, duke e lënë me një barrë pikëpyetjesh pa përgjigje dhe një lëshim dufi që pret të shpërthejë. "Lidhëse" titullohet libri i Domenico Starnone përkthyer nga Mimoza Hysa. Ai ka dhuruar historinë e një arratie, e një kthimi, historinë e të gjitha dështimeve, të atyre që na duken të pakapërcyeshme dhe të atyre







që na shoqërojnë për gjithë jetën.

Pas kryeveprës së Magrisit, "Danub", të botuar një vit më parë, "Historia e një kordhe" është titulli i dytë i këtij autori që vjen në shqip nga shtëpia botuese ALBAS, përkthyer nga Alma Hafizi. I bazuar në një fakt historik, tregon si gjermanët pushtuan Karninë, me ndihmën e aleatëve të tyre kozakë, të cilëve u kishin premtuar një truall, ku të ndërtonin atdheun e pavarur kozak. Kozakët zbuluan se ishin përdorur dhe mashtruar, e zgjidhën vetëvrasjen kolektive në lumin Dravë. Claudio Magris nxitet të shkruajë një ese prekëse mbi fatin dhe tragjedinë e jetës, ku protagonistit është gjenerali i vjetër i kozakëve, Krasnovi.

"Të qetë në kohë lufte" nga Cristian Crusat përkthyer nga Bajram Karabollit, është një libër personazhesh, më shumë se intrigash.

"Ju shkruaj në errësirë", Jean-Luc Seigle, përkthyer nga Rina Çela Grasset dhe Luan Rama. 1961. Polinë Dybuison arratiset nga Franca drejt Marokut, me një emër të rremë, për t'i shpëtuar së shkuarës së saj. Kur i dashuri i saj, Zhani, i kërkon të martohen, ai nuk e di se cila është ajo në të vërtetë. Për ironi të fatit, ai e njeh shumë mirë historinë e saj, sepse të rrallë janë ata që nuk e kanë parë filmin e famshëm me Brixhidië Bardone, të frymëzuar drejtpërdrejt nga jeta e →





← Polinës, që bëri kaq bujë në Francë. "Histori e shkurtër e rrëmujës" i Loer Kumes, është një pikturë e madhe sferike e vështirë për t'u përfshirë në një vështrim të vetëm. Deani, në bashkëpunim me mikun e tij matematikan, krijon një Parim Shkencor mbi të Drejtën. Me këtë armë në dorë ai nisat që të vendosë drejtësi në botë, me një plan të madh real. "Martin Camaj ende i pazbuluem" (shkrime, kujtime, intervista) nga Hans-Joachim Lanksch.

DUDAJ

Shkrimtari i shquar Salman Rushdie vjen me librin "Klouni Shalimar" një roman i shkruar në mënyrën e tij, ngacmuese, stilistike, të një mjeshtri të padiskutueshëm të letërsisë moderne. Ngarjet zhvillohen, në Nju Jork, po emrat e personazheve janë indianë, historitë aty brenda të përbotshme. Një histori që nis me një vrasje, një vajzë që quhet India vritet nga një personazh i çuditshëm i mbiquajtur Klouni Shalimar. Teksa historia lidhet me babanë e saj duket një vrasje politike, por, në fakt, është një vrasje pasioni, dhe rrënjët gjenden shumë thellë. Salman Rushdie i lidh aq bukur me një mënyrë super të sofistikuar shkrimi që është veç e tij. Isabel Allende shkrimtarja aq e dashur për shqiptarët, shkrimtarja që na mësoi të shijojmë realizmin magjik dhe historitë e saj të mrekullueshme, vjen me një libër që nuk është roman, edhe pse ajo çdo libër e shkruan si roman. "Vendi im i imagjinuar një udhëtim nostalgjik nëpër Kili". Ken Follett vjen me librin e tij më të rëndësishëm "Shtyllat e Tokës", ku është në qendër ndërtimi i një katedraleje, ngjarjet zhvillohen në mesjetë, por luftërat që zhvillohen për pushtet, pasion, dashuri i duket se i përshpërthen fare mirë edhe ditëve tona. Norvegjezi Jo Nesbo, një zbulim për ata që adhurorin thrillerin. Historia tërheqëse është vetëm gripi që të zhyt në leximin e librit "Gushëkuqi" aty brenda ka qaq shumë ftohtësi Norvegje, një mënyrë të veçantë të menduarit, një figurë e dashur e detektivit Harri Hole me gjithë kompleksitetin e një njeriu të turbulluar, po të drejtë. Spanjoli i famshëm Javier Cercas vjen me një roman-jo roman i titulluar "Mashtroesit". Një njeri i quajtur Enrique Marko ka manipuluar krejt të shkurarën e tij duke

e quajtur veten një të mbijetuar të Holokaustit. Por këtë gjë e ka bërë kaq mirë, sa perfekte aq edhe naive, duke arritur të bëhet edhe kryetar i shoqatës të të mbijetuarve. Barrington Moore me kryeveprën e tij "Origjinat shoqërore të diktaturës dhe të demokracisë", analizon dhe i jep përgjigje pyetjeve të tilla si: përse disa vende ecën dhe u zhvilluan drejt demokracisë dhe përse disa të tjera drejt totalitarizmit dhe diktaturave?

TOENA

Nga letërsia e huaj, sjell të përkthyer në gjuhën shqipe, autorë nga më të vlerësuarit dhe më të lexuarit, si: nga letërsia braziliane Paulo Coelho "Spiunia" me përkthim të Erion Gjatollit; nga letërsia franceze Eric Faye "Nagasaki" - romani që u vlerësua me çmimin e madh për romanin nga Akademia Franceze në 2010 me përkthim të Blerta Hyskës; Albert Cohen "Libri i nënës sime" me përkthim të Amantia Kapos; Eric Emmanuel Schmitt "Helmi i dashurisë" me përkthim të Amantia Kapos; Yasmina Reza "Zoti i masakrës", me përkthim të Nasi Lerës. Nga letërsia angleze Rosamunde Pilcher "Solstici dimëror" me përkthim të Shpresa Osmeni; Robert Wilton "Merimanga e Sarajeves" me përkthim të Diana Çulit; nga letërsia greke Lena Manda "Theanoja, ujkonja e Stambollit", me përkthim të Kristo Pullës. Nga letërsia shqipe Besnik Mustafaj "Biri i Adamit" është libri më i ri me poezi i tij që do prezantohet për herë të parë në këtë Panair; Sadik Bejko me "Këngë të Solomonit", poezi - një befasi tjetër e këndshme për ne dhe lexuesit; Namik Dokle troket për herë të dytë me një roman të ri "Lulet e skajbotës". Botimet Toena kanë dy të ftuar speciale në këtë Panair: shkrimtarin francez Eric Faye që do të promovojë romanin e tij "Nagasaki" në shqip - roman për të cilin Akademia Franceze e vlerësoi me Çmimin e Madh të Romanit 2010 dhe shkrimtaren greke Lena Manda që do të promovojë në shqip romanin e saj "Theanoja, ujkonja e Stambollit" - Historia e një graje që përjetoi si dashurinë, ashtu dhe urretjen dhe që rrethant e shndërruar në egërsirë... për hir të njerëzve të saj të dashur. Lena Manda është autorja absolutisht më e lexuar e dhjetë viteve të fundit në greqisht, me mbi 1,700,000 kopje të shitura.

PANAIRI NIS ME 'PROTESTË' PËR TAKSAT, PËRPLASJE MES MINISTRES E BOTUESIT



FATMIRA NIKOLLI

Panairi nis me "protestë". Një pankartë e madhe ku citohe Umberto Eco, proteston kundër taksave në kulturë. "Mos taksoni kulturën, mos taksoni librin"- Umberto Eco, shkruhet në pankartën e katit të dytë të Pallatit të Kongrese, ku prej ditës së djeshme e deri të dielën mbahet Panairi i Librit. "Shteti të finançojë bibliotekat publike", shkruhej në një tjetër pankartë. Shqetësimi kryesor për botuesit mbetet nxitja e leximit, por përkundër kësaj, problem po aq madhor në kohën krizës së leximit, botuesit thanë se është ulja e taksave. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, premtoi se do të vazhdojë të kërkojë uljen e taksës së krijimtarisë, por mes Kumbaros dhe kreut të Shoqatës së Botuesve, Petrit Ymeri pati përplasje edhe për "bibliotekat" me tulla.

BOTUESIT PËR TAKSAT

Në emër të Shoqatës së Botuesve, duke kujtuar vitet e gjata të punës e duke falënderuar të gjithë botuesit, Petrit Ymeri tha dje se "E ndjej për detyrë të nënvizoj shkurtimisht disa probleme dhe sfida". Ritheksoi se "Kemi një TVSH 20%, në blerje, pra në shtypshkrim, i pangarë në asnjë vend evropian, ku luhatet midis 4 dhe 6%, kemi 0% në shitje, dhe ky taktim nuk i prek të gjithë operatorët apo subjektet që botojnë. Çfarë kërkojmë: TVSH të ulët, 5%, në blerje dhe në shitje, dhe të përfshijë të gjithë ata që botojnë libra: fondacione, institute, qendra fetare apo kulturore apo çdo lloj tjetër. Çdo lloj libri që shitet të ketë TVSH. Ato mund e duhet të pajisen me NIPT të veçantë për botimin. Po kështu kërkojmë që të ndahet nga organet tatimore veprimtaria e shtypshkronjave nga ajo e Shtëpisë Botuese si veprimtari me NIPT më vete. Kjo gjë do të zvogëlojë edhe rrjedhjet fiskale". Ymeri në emër të shoqatës kërkoi të ulet taktimi mbi të ardhurat për veprimtarinë krijuese nga 15% në

“
Ironia e Ymerit se bibliotekat nuk janë tulla, Kumbaro: Rigjenerimi nuk ka të bëjë me vetratat



5%. "Nuk mendojmë se shteti i vjen ndonjë dëm nga kjo gjë, është mendoj e papërfillshme në buxhet, përveç faktit që nuk ka ndonjë kontribut të dukshëm në krijimtarinë e autorëve apo përkthyesve", shtoi ai duke vënë theksin se një problem i madh mendoj, madje prioritet kombëtar, duhet të jetë pasurimi bibliotekave publike, të shkollave, institucioneve arsimore publike, të bashkive e komunave. "Këto furnizime të bëhen të hapura, transparente, jo me lista klienteliste, por bazuar në vlerat e librave e autorëve. Të mos këmbëngulet në investime ndërtimore, por në pasurime me libra. Bibliotekat i bëjnë librat, jo tullat dhe pllakat e bukura apo vetratat. Libri e zbukuron bibliotekën".

REAGIMI I MINISTRES

Mirela Kumbaro, ministere e kulturës, u pa dje përkrah Petrit Ymerit në konferencën celëse të panairit. Ymeri ka qenë botues i saj, por me ardhjen e saj si ministere, marrëdhëniet mes tyre kanë qenë të ndryshme, duke arritur deri të sulmet publike. Në një kohë që duket se kanë vënë pagë. Megjithatë, ajo iu përgjigj deklaratis së para tri ditëve të Ymerit, i cili kritikoi bash-

kinë e Tiranës duke thënë se "Bashkia e Tiranës është duke vënë tulla nëpër biblioteka. Biblioteka është libri, jo tulla, p.sh të lagja nr.9 është një bibliotekë që është rikonstruktuar disa herë, ndërkohë që ka qenë një nga bibliotekat më të mira në Tiranë. Ato fonde të shpenzohen për të blerë libra, që nuk mund t'i blejë kryetari i bashkisë".

Dje Kumbaro tha se "Me Bashkinë e Tiranës, jemi në një program rigjenerimi dhe kuptohet që nuk bëhet fjalë për tulla e vetra, por bëhet fjalë për aktivitetet të cilat nuk mund të jenë vetëm të librit, sepse natyra e librit sot është e tillë, që nuk e ka më rolin e Princit të kulturës, që ka pasur dikur, kjo është pjesë e evolucionit të shoqërive tona". Kumbaro tha se "Në programin për leximin, jemi në pikën më të fortë për të mos gjujkuar njëri-tjetrin. Unë i kuptoj qesënditë që shoqëruan dy vjet më parë, kur dy vjet më parë Ministria e Kulturës e theksoi shumë fort që politikat e librit e të shtetit duhet të jenë të drejtuar të lexuesi me L, të madhe, sepse pa lexues nuk ka as botues, as përkthyes, as autorë, vdes edhe libri vetë".

Shkrimtari Agron Tufa, shtoi se "Unë mendoj se duhet rregulluar një pikë: t'i shkojmë lexuesit. Atij nuk i shkohet ndryshe nëse nuk shpërndahet libri mirë. Nëse ne kemi menduar një shtet brenda shtetit Tiranën, dhe kemi pushuar së menduari se ekzistojnë një sërë qytetesh të mëdha, dhe provincat e Shqipërisë ku nuk shkon libri". Sipas tij, edhe në rastet kur shkon, na ka dalë një instancë e çuditshme që quhet librashitës, dhe ai përfundimisht merr vendimet, ekzekuton dhe të pranon se çfarë libri të shesë, çfarë libri të marrë, dhe çfarë libri të porosisë. Për ata ekzistojnë miti i pashembshëm, letërsia e huaj, klasika apo moderne, dhe fillohet në këtë vend autori shqiptar. Në Panairin e njëzetët të Librit marrin pjesë 95 shtëpi botuese, ndërsa janë rreth 100 tituj të rinj që i ofrohen lexuesit për gjatë 5 ditëve, ku dominon letërsia e huaj ndaj autorëve vendas.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e dytë

Ish-të përndjekurit, 5000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 5000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjet me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje për përfituesit e këstit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rast kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë

që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjat kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe

rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt

vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblim.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E DYTË

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
6612	Vlasi	Dushaku	1231	Vasi									V	V	V	V
				Violeta	Vlasi	Dilo							V	V	ZV	
							Vasil	Kostandin	Dilo				V	V		
							Esmeralda	Kostandin	Mara (Dilo)				V	V		
				Aneta	Vlasi	Theodhosi							V	V	ZV	
							Petra	Dhimitri	Theodhosi				X	X		
				Donika	Vlasi	Jovani							V	V		
				Polikseni	Vlasi	Koçi							X	V		

Dosje e shqyrtuar me 15/08/2017

Vasht e trashëgimtarëve: Donika dhe Polikseni i dhe me v. fëmijet e Violeta, Vasil dhe Esmeralda dhe fëmijet e Aneta, Petra, Vasil, Esmeralda, Donika dhe Polikseni e kanë tërhequr këstin e tyre të dytë.
 Prokurë e vitit 2014 e bere nga Donika ne emer te Z. Hasan Gromi dhe ose Eltoni Gromi edhe per bankat.
 Mungon nje fotokopje te certifikate personale per Polikseni.
 Fotoja nuk ka te rregulluar keshtu keshtu me mund te shprehesh sepo nuk ka sjelle dok e tij ligjore: certifikate personale/fotoje ID dhe nr. llogarie.

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
3390	Abdulla	Abazi	707	Hasan									V	V	V	V
				Hasfa	Abdulla	Abazi							V	V		
				Enver	Abdulla	Abazi							V	V		
				Hasan	Abdulla	Abazi							V	V		
							Alma	Hasan	Bishajaku				V	V		
							Alben	Hasan	Abazaj				V	V		
							Sejrije	Hasan	Shabanaj				V	V		
				Vangjeli	(Sadije)	Abdulla	Telaha						V	V	V	FOI
							(Hajro)	Kola					V	V		
							(Hoxha)	Mitriushi					V	V		
							Rudina	(Qerrollari)	Jani				V	V		
							Ngjeshush	(femal)	Toska				V	V		
							Jorgo	(femal)	Jani				V	V		
							Lindita	(femal)	Beqiri				V	V		
							Illa	(femal)	Jani				V	V		
									Dhimitri							

Dosje e shqyrtuar me 16/08/2017

Abdulla e trashëgimtarëve: Hasfa, Enver, Hasan dhe Sadije.
 Hasan e trashëgimtarëve: Alma, Albert dhe Sejrije.
 Sadije e trashëgimtarëve: Vangjeli, Ilirjana, Rudina, Engelusha, Jorgo, Lindita dhe ILLA; dëshmia e trashëgimisë e Sadije është fotokopje jo e notestuar/! Duhet origjinalja ose nje fotokopje sa dije ka ndryshuar emrin ne Andromag!
 Mimosa e ka ndryshuar emrin ne Vangjelia
 Ilirjana e ka ndryshuar emrin ne Janna dhe mbiemri ne Mitriushi
 Rudina e ka ndryshuar emrin ne Jani
 Ismail e ka ndryshuar emrin ne Dhimitri.
 Arjan e ka ndryshuar emrin ne Jorgo por nuk kemi nje dok qe e vereton.
 Alfredo e ka ndryshuar emrin ne Illa por nuk kemi nje dok qe e vereton.
 Fotoja e bere nga Rudina Jani ne emer te se motres: I lidha Beqiri/NUK ENJTE E VLESFEMSE.

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
8923	MEXHET	DARI		SHEFIK									V	V	V	V
				ZEQULI		DARI							V	V	V	V
				ARJANA		MEXHET	DARI						V	V	V	V
				GOJARI		MEXHET	DARI						V	V	V	V

Dosje për pagesë për këstin e dytë

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
3580	Murat	Koçi	1099	Zyher									V	V	V	V
				Xheladin	Murat	Koçi							V	V		
				Gani	Murat	Koçi							V	X	X	
				Lufije	Murat	Kraja							V	X	X	
				Nashije	Murat	Shala							V	X	X	

Dosje e shqyrtuar me 16/08/2017

Murat e trashëgimtarëve: Xheladin, Gani, Lufije dhe Nashije.

Ne vares te dëshmitë te trashëgimisë, trashëgimtarët e Gani, Lufije dhe Nashije duhet te sjellin edhe certifikat personale dhe nr e tyre te llogare bankare.

Xheladin është paguar për këstin e tij të dytë.

Mungon dëshmia e trashëgimisë dhe certifikata e trungru familjar per Gani, Lufije dhe Nashije.

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
5231	Akif	Përmeti	1099	Ismail									V	V	V	V
				Sadet		Përmeti								V	V	V
				Astrit	Akif	Përmeti							X	V	V	V
				Feti	Akif	Përmeti								V	V	V
							Ilirjan	Feti	Përmeti				V	X		
							Ernal	Feti	Përmeti						V	
							Mirjam	Feti	Deputi						V	P
							Ardian	Feti	Përmeti						V	V
				Shujpe	Akif	Kosova							X	V		

Dosje e shqyrtuar me 15/08/2017

Akif e trashëgimtarëve: Sadet dhe fëmijet: Astrit, Feti dhe Shujpe

Sadet e trashëgimtarëve: Astrit dhe Shajpe

Feti e trashëgimtarëve: Ilirjan, Ernal, Mirjam dhe Ardian

Ernal ka nderruar jete dhe pleja e tij ka jete per ilirjan, Mirjam dhe Ardian

Mirjam ka bere prokure ne emer te Ardian.

Astrit dhe Shujpe e kanë tërhequr këstin e dytë.

Mungon certifikata e vdekjes se Sadet.

Mungon certifikate personale/fotoje ID per Astrit dhe Shujpe.

Mungon nje nr llogarie per Ilirjan.

FORMULARI MBI PËRCAKTIMIN E TRASHËGIMTARËVE, RRETHI I FAMILJAREVE TË PËRCAKTUAR NË UJLË, PËR PAGESIN E KËSTIT TË DYTË

Shënim: Kur dokumentacioni është i rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

KËSTI I DYTË																
ISH I DENIARI POLITIK				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË PARË				TRASHËGIMTARËT E NIVELIT TË DYTË				DOKUMENTAT				
NR. DOSHES	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	DATELINDJA	KOPIJE TË LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKAR	CERTIFIKATË VDEKJE	CERTIFIKATË E TRUNGUT FAMILJAR	DESHIMI TRASHËGIMIE	PROKURE
7822	Ndok	Ndoj	230	Llesh									V	V	V	V
				Mare	Prenid	Ndoj								V	V	V
				Dile	Ndoka	Marta (Ndoj)								V	X	X
				Mrike	Ndoka	Prenid (Ndoj)							V			P
				Gjok	Ndoka	Ndoj							V			P
				Llesh	Ndoka	Ndoj							V			P
				Kol	Ndoka	Ndoj							V			P
				Dave	Ndoka	Ndoj							V			P
				Prenide	Ndoka	Biba							V			P
				Zef	Ndoka	Ndoj							V			P
				Luigi	Ndoka	Ndoj							V	V		V

Dosje e përfunduar e rishqyrtuar me 30/08/2017

Ndoka e trashëgimtarëve: Mare dhe fëmijet: Dile Mrike, Gjok, Llesh, Kol, Dave, Prenide, Zef dhe Luigi.

Dile ka nderruar jete dhe nuk ka sjelle certifikatën e trungru familjar dhe dëshminë e trashëgimisë. (Ne vares te dëshmitë se trashëgimisë, trashëgimtarët e Dile duhet të sjellin Mrike, Gjok, Llesh, Kol, Dave, Prenide dhe Zef kanë bere prokure ne emer te Luigi.

Mrike, Gjok, Llesh, Kol, Dave, Prenide, Zef dhe Luigi do të paguhet për këstin e dytë.

Opiniononi i Ditës

Mimoza Koçiu

(Vijon nga faqja e parë)

... që shkonte përtej kufijve klasikë të atyre normave që pranohen si të tilla në çdo shoqëri. Batutat për të, vijën edhe nga njerëz pranë tij, mbi performancën në këto ditë të vështira, shëtitjen e qeverisë fundjavave nëpër rrethe për mbledhje, e deri tek ulja nëpër tryezat e varfra të qytetarëve, ku u flet për politikën e madhe, e hallet e veta, siç ishte rasti mbi reportazhin e emisionit investigativ "Le Iene" në Bulqizë. Me mospërmbajtjen tipike inatçore, që nuk ia latuan sadopak 5 vite në krye të qeverisë, i quajti "kazan" edhe gazetaret investigativë italianë, siç bën me lehtësinë më të madhe me gazetaret shqiptarë. Por përgjigja me prova e gazetarëve italianë, bëri që kryeministri të tërhiqej, të pranonte se ishte nxituar, e se e kishte paragjykuar pa e parë vetë si reportazh.

E pohoi në studion e Eni Vasilit, kryeministri që gazetaret shqiptarë i quan "kazan", të paditur, injorantë, që nuk lexojnë, e që flasin pa lidhje, pa lexuar e verifikuar faktet.

E tha shefi i qeverisë që çdo informacion, mbi çdo situatë, e ka veç një telefonatë larg.

E tha një kryeministër që një-lloj në këto 5 vjet, ka refuzuar të konsiderojë problematikat që i janë evidencuar.

Pamë se si një kryeministër që nuk pranon realitete ndryshe nga ato filmon e shpërndan vetë në media, u mpak me gjithë shtat-lartësinë e tij, para fuqisë investiguese të një medie të huaj, të cilën nuk e kontrollon dot.

Pamë se si i njëjti kryeministër, nuk pati as më të voglin refleksim mbi atë realitet skandaloz, që pasqyronte reportazhi i "Le Iene", sesi fëmijë të vegjël në shtetin që menaxhon ky kryeministër, mbledhin krom për 2 cent kilogramin, për të ndihmuar familjet. Çka dëgjua inishin klishetë e njohura se merak u i tij është të bëjë shtet.

Por standardi i dyfishtë i kryeministrit, u pa edhe në raport me median e vendit të vet. Kjo pasi sjellja e padenjë ndaj një medie të huaj, nuk është e panjohur e për median shqiptare. Me një praktikë të mirëmenduar, më shumë se shmangien e vëmendjes ndaj ngjarjeve të rënda që implikojnë qeverinë e tij, kryeministri po synon të godasë pikën më të fortë të medias, besueshmërinë e saj. Me gjithë problematikat që ka sot media shqiptare, të cilat nuk hyjnë në përshkrimin e punës së kryeministrit, koha i ka vërtetuar raportimet e investigimit e saj, posaçërisht për kanabisin e krimin me lidhje e mbrojtje politike. Ky është një fakt kokëfortë, i cili i reziston, i shkruar e zezë mbi të bardhë, me zë e figurë, që do shpërthim të menduar a të momentit të kryeministrit.

Ndër vite, në çdo sondazh të publikuar, jo të kryeministrit, mbi besueshmërisë e qytetarëve tek institucionet, media është rënditur gjithnjë para politikës, e me diferencë shumë më e besueshme se ajo.

Kjo është arsyeja që kryeminis-

Spërdredhjet e një kryeministri



tri ka ndërmarrë një fushatë ndaj saj, në mënyrë që denoncimet e investigimet, që kanë qenë mbresëlënëse vitet e fundit nga media shqiptare, të mos kenë efektin e deritanishëm në opinionion publik. Kryeministri vijon të thotë se nuk i heq asnjë presje "opinionit" të tij për mediat e vendit të vet, të cilat i nxijnë realitetin, atë realitet që ai vetë më shumë përkushtim artistik e monetar, e përgatit në zyrat e tij, dhe ua dërgon të gatshme për transmetim atyre mediave që i anatemon.

Cili kryeministër para tij, i majtë a i djathtë, e ka bërë këtë gjë në mënyrë sistematike me mediat, e duke i quajtur "kazan"?

Në cilën qeveri paraardhëse, të majtë a të djathtë, ministri i Brendshëm, përgjegjës për luftën kundër kanabisit e krimin të organizuar, po hetohet për lidhje me të?

Në cilën qeveri të majtë a të djathtë, ka ndodhur që të bien avionët e drogës, e kryeministri të thotë se janë mushkonja?

Në cilën qeveri ka ndodhur që kryeministri të flasë për sukses në luftën kundër drogës, kur mediat italiane raportojnë sistematikisht, kapjen e tonëve të tëra me kanabis, të futura nga Shqipëria?

Në cilën qeveri, kryeministri, teksa flet për sukses në luftën kundër krimin të organizuar shpall ardhjen e FBI e agjentëve të spe-

cializuar gjermanë, britanikë e italianë për ta luftuar atë?

Në cilën qeveri, kryeministri në vitin e pestë në detyrë, thotë se përgjegjësitë, qoftë edhe morale, qenkan të vartësve, por jo të atij vetë, që i ka zgjedhur e i ka mbrojtur ashpërsisht e kokëfortësisht para çdo denoncimi publik?

Në cilën qeveri ka ndodhur, që një ambasador të thotë copë, se krimi është i lidhur me politikën, e të rendisë emra konkretë, shumica të përzgjedhur nga ky kryeministër?

Në kushtet kur beteja verbale e opozitës nuk e impresionon, kryeministri ka kthyer sytë nga media, ajo që nuk ka interes si opozita, që t'i zërë karrigën, por që po raporton e investigon anën tjetër të kësaj qeverie.

Sulmi ndaj besueshmërisë së medias është dëmi më i madh që i bëhet demokracisë, që ka si themel fjalën e mendimin e lirë, e këtë Edi Rama e bën nga karrigia e kryeministrit, në mënyrë aspak të paqëllimshme a të pavetëdijshme.

Për fat të mirë, gazetaret shqiptarë nuk kanë nevojë të lodhen shumë për të marrë solidaritetin e kolegëve jashtë vendit për sulmet e shefit të qeverisë. U jep një dorë vetë kryeministri i vetëkënaqur.

E bëri pa u matur fare para një audience me 250 përfaqësues të mediave nga Shqipëria e rajoni. U shfaq si viktimë e medias së ven-

dit të vet, e madje tha se pas fjalëve vijnë edhe plumbat. Moment më të gabuar për të përmendur vdekjen nuk mund të kishte, pasi pak javë më herët një gazetare investigative malteze, që denonconte korrupsionin qeveritar, u hodh në erë me një bombë në makinën e saj. Ishte ky rast tronditës që e sollti edhe komisioneri Hahn në atë konferencë, si një kujtesë së Brukseli tani po merret seriozisht me lirinë e cenuar të medias, edhe në Ballkanin Perëndimor.

Një kryeministër që flet me zë e figurë për media super të pasura, që i bëkan presione, pa dhënë asnjë emër, nuk perceptohet thjesht si i pafuqishëm a viktimë e tyre, por edhe qesharak, teksa u turrent për 8 minuta e me fyerje pa fre, reporterëve në oborrin e parlamentit.

Prandaj, ky kryeministër zhgënjën keq, sepse nga artisti rebel i viteve të para të pluralizmit, që forcë të spikatur kishte fjalën në emër të lirisë, nuk ka mbetur veçse një kryeministër i shtypur nga pesha e pushtetit të mbledhur, e mëkateve jo të vogla të rebel, e vartësve, që pasi i vihen në rresht, nuk e kursejnë nëpër tryeza për performancat e tij pa asnjë lloj vetëpërmbytje, të njëjtit vartës, që duket e kanë më të thjeshtë ta shndërrojnë në histori tryezash, sesa t'i thonë: -Ndalo Edi, se po bëhesh çdo ditë e më qesharak.

HOROSKOPI

DASHI
Si ndërmjetës të natyrshëm, këtë të enjte do jeni të mbështetur edhe nga yjet dhe nuk do gjendeni kurrë në vështirësi. Do dilni nga situata me lehtësi të madhe. Ndoshta duhet të shqetësoheni vetëm nga objektivi i juaj total.

DEMI
Mos i refuzoni ndihmë një miku që ka nevojë për ngushëllim, edhe pse në thelb, po e bëni për veten tuaj. Qëllimi juaj është të bëni dikë të lumtur. Nuk është e thjeshtë të kuptosh se ku duhet të ndalosh, pa pushtuar privatësinë e të tjerëve. Ndoshta thjesht ju duhet pak praktikë.

BINJAKET
Të ëndërrorsh më shumë se duhet nuk është e gabuar, përkundrazi! Dhe Mërkuri në një kënd hyjnor me Neptunin do t'ju ndihmojë të përmirësoni ndeshmërinë tuaj. Nëse në të shkuarën nuk jeni tërhequr kurrë, ndoshta ka ardhur koha të ndryshoni! Hapin e parë duhet ta bëni ju!

GAFORJA
Do keni të bëni me Hënë në kuadraturë me Neptunin, pa llogaritur që kolegët, të cilëve u keni ngarkuar një detyrë, do t'ju zhgënjëjnë. Kështu, herë tjetër mendoheji u derë para se të delegoni dikë ta kolegët. Megjithatë do t'ia dilni të përfundoni detyrën vetë dhe në kohë.

LUANI
Fantazia nuk është gjë e madhe. Në vend që të rrini para pasqyrës, më mirë përqendrohuni në një përgatitje të fortë, pa lënë mënjana asnjë detaj. Nëse fati nuk ju buzëqesh, përveshni mëngët dhe ndiqni këshillat e miqve ekspertë dhe të pjekur.

VIRGJERESHA
Do arrini të falni dikë që do ju flasë me një gjuhë të ashpër, ndoshta sepse do kuptoni që personi nuk e ka bërë me qëllim. Krenaria nuk është problem nëse dini të përmbaheni duke vënë miqësinë në plan të parë.

PESHORJA
Do keni të bëni me një person pak kokëfortë. Nuk do ta keni aspak të lehtë që t'i ndryshoni mendjen, por në fund do jeni shumë të kënaqur. Me gjuhën tuaj do jeni të aftë të bindni këdo me saktësinë e argumenteve tuaja.

AKREPI
Mendjemprehtësia për biznes nuk ju lë në balatë dhe mund të mblybi marrëveshje të shkëlqyera pa u sforcur. Në vend që të reagoni, do mësoni të veproni duke ndjekur një arsyetim të kujdesshëm më shumë sesa instinktin tuaj.

SHIGJETARI
Nëse nuk do përfshihen nga nxitimi dhe ankthi i performancës tuaj, intervista e punës do shkojë mirë dhe do lini një përshypje të mirë tek të gjithë. Për të mbajtur llogarinë tuaj bankare aktive, përqijuni të evitoni shpenzimet e kota dhe kufizoni shpenzimet në minimumin e domosdoshëm.

BRICJAPI
Dita do jetë pak e ngadalët duke qenë se nuk dini si të menaxhoni disa çështje. Rëzhironi të përmirësoheni, por në këtë moment duhet të mjaftoheni me rezultatet e arritura.

UJORI
Nëse në të shkuarën taktika që keni përdorur gjatë aktiviteteve ka funksionuar, atëherë mos e ndryshoni pikërisht tani pasi mund të humbim kontrollin e situatës. Nuk ju duhet të improvizoni, thjesht ndiqni logjikën tuaj të fortë dhe të pa-kundërshtueshme.

PESHQIT
Keni një nxitje të madhe, e cila mund të jetë e dobishme për të shkëlqyer në shumë rrethana dhe për të marrë shumë vlerësime dhe komplimente. Mos u dorëzoni para vështirësive. Janë thjesht stimuj për t'u përmirësuar dhe për të bërë akoma më shumë gjëra.

Opinion *i* Ditës

Nga dr. Jorgji KOTE

(Vijon nga faqja e parë)

... e vet grek, Kotzias ishin hap dhe veprim i duhur madhor politikodiplomatik. Mbi të gjitha, ato i kanë dhënë një shtytë të fuqishme demarshive të mëtejshme për zgjidhjen e çështjeve të ndërlikuara, si ato të trashëguara ashtu dhe të krijuara vitet e fundit nga qeveritë paraardhëse, që janë në opozitë në të dyja vendet. Ndaj, të dyja palët meritojnë përgëzimet më të mira për këtë nismë të rëndësishme dhe premtuese.

Për të ardhur deri në Kretë, diplomacia jonë zyrtare në bashkëpunim me dikasteret e interesuara ka ndërmarrë shumë hapa dhe lëvizje të dobishme dhe jo të lehta, mes trysnive dhe pengesash të shumta. Edhe pse sipas parimit "tërhiq e mos këput", të diktuar kryesisht nga nevojat për të mos përkeqësuar më tej statuskuonë ndërmjet dy vendeve fqinj, "Menuja" e problemeve të diskutuara në Kretë, jo më me logjikën e forcës, por me forcën e logjikës tashmë njihet; ajo është tejet e ngarkuar dhe e ndërthurur me shumë elemente politike, ligjore, ekonomike, etj. Pa dyshim përfshirja e çështjes çame është hap tjetër inkurajues.

Megjithatë, parë nga këndvështrimi i diplomacisë reale, është naivitetet i madh të kërkosh rezultate konkrete apo sukses në një vizitë të kësaj natyre, apo të pretendosh se tematika e saj "djegëse" mund e do të zgjidhet brenda një muaji apo viti dhe ca më pak e gjitha njëherësh. Kusido që e njëj dhe ka punuar në këtë fushë e di mirë se diplomacia i zgjidh problemet një e nga një, duke i hapur rrugën njëra-tjetër, me "nge" dhe jashtë çdo lloj trysnie/paragjykimi. Ndryshe, ashtu si ka ndodhur pa shkuar më larg 10 vjet më parë, hapat e nxituara në një element të caktuar do ta kthenin në bumerang ose vononin ndjeshëm gjithë axhendën diplomatike, përfshirë dhe anëtarësimin në BE.

Kësajsoj, sukcesi dhe rezultati më i madh i Kretës është konfirmimi i frymës, dëshirës dhe vullnetit politik të të dyja palëve për bashkëpunim të qëndrueshëm e jo koniunkturo, duke shmangur premisat dhe precedentet e reja negative. Kjo u vërejt qysh në profilin modest të protagonistëve të këtij takimi, larg bujës/zhurmes, euforisë dhe tamtameve të mëparshme. Po aq e rëndësishme është se shpejti do të ketë takime të tjera post-Kretë në Tiranë e më tej.

Tani, çështja shtrohet që të mos na ikë momenti nga duart; duke e lënë tematikën konkrete, hartat, kodet, traktatet, etj. në dorë të ekspertëve dhe agjencive përkatëse që të vijojnë punën post-Kretë, sukcesi i vërtetë i këtij procesi kërkon domosdoshmërisht rikrijimin dhe konsolidimin e trullit, terrenit, mjedisit dhe klimës së duhur politike mes të dy vendeve tona. Që të ngushtohen në minimum hapësirat e veprimit për elementet dhe forca që bien ndesh me vlerat, parimet dhe interesat, pse të mos të themi, të dy popujve tanë miq.

Mirëpo këtë komponent mad-



hor dhe shumëdimensional nuk mund ta jetësojë dot asnjë lloj diplomacie, sado e aftë që të jetë. Për më tepër që sfidat madhore në marrëdhëniet greko-shqiptare i kalojnë caqet e diplomacisë klasike shtetërore; ato kërkojnë krijimtari, iniciativë, vizion, guxim dhe frymë të vërtetë evropiane me mbështetjen e fuqishme dhe të "variabëlve" të tjerë po aq të efektshëm - diplomacinë parlamentare, ekonomike, publike, kulturore dhe qytetare; të kombinuara në konceptin/praktikën moderne të "multi-track diplomacy" ose diplomacia integrale, tejet "në modë" sot. Kjo bëhet dhe më e domosdoshme kur vjen fjala për vende të tilla fqinje, si Greqia, me të cilën kemi shumë më tepër traditë/interesa të përbashkëta se sa vija ndarëse. Nevoja e lartpërmendur bëhet dhe urgjente pasi bilanci në këto fusha të paktën gjatë 15 viteve të fundit ka qenë i varfër dhe larg mundësive reale. Le të jemi më konkretë duke shtruar këto pyetje/çështje.

Duke vlerësuar hapat në disa drejtime fusha të tjera, si dhe sa ka kontribuar në këtë fushë diplomacia parlamentare e të dy vendeve gjatë viteve të fundit, veç ndonjë vizite të nivelit të lartë, apo mbledhjeje të Komisionit të

Jashtëm? A është në nivelin e dëshiruar roli i deputetëve në përgjithësi dhe atyre të minoritetit grek në veçanti në këtë fushë? Çfarë nismash/demarshesh ka ndërmarrë grupi përkatës parlamentar i miqësisë me homologët e vet grekë, kur jo në një rast kanë qenë deputetë ata që i kanë "fryrë zjarrit" nacionalist?

Të pashfrytëzuara kanë mbetur dhe hapësirat e shumta që krijon diplomacia ekonomike/sipërmarrjes. Ndonëse kemi dhjetëra kompani dhe firma aktive me tregti dhe investime, banka, dhoma tregtie, panairë, etj. roli i tyre jashtë profilit komercial ka qenë pothuajse i papërfillshëm. Sa për kujtesë, vendosja e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve 45-vjet më parë, erdhi dhe me përfshirjen e Dhomave të Tregtisë të dy vendeve në procesin e bisedimeve. Gjithashtu, Panairi Ndërkombëtar i Selanikut ishte një dritare e dobishme dhe për njoftjen/shkëmbimin e vlerave kulturore, shpirtërore dhe artistike. Sepse mallrat dhe shërbimet, veç aspektit material dhe tregtar, kanë të mishëruar në to dhe vlerat/mesazhet e shumta të mishëruara në to.

Edhe më i dobët ka qenë profili i diplomacisë publike. Këtë kemi

parasysh në radhë të parë shtypin dhe median, por dhe publikun e gjerë - OJQ-të, shoqërinë civile, arsimin, historinë, etj. Në vend të njoftimeve e reportazheve për aspekte pozitive që bashkojnë të dy vendet, në to mbizotëron shpesh fryma ndarëse, negativizmi dhe nihilizmi.

Publiku i të dy vendeve "bombardohet" kryesisht edhe pse jo pa arsye me lajme dhe njoftime mbi krime, bllokime në pikat kufitare, protesta në Himarë, largime të fëmijëve të dalluar shqiptarë nga paradat festive në Greqi, nota proteste, etj. Kur ka aq shumë vend dhe për pasqyrimin e dukurive pozitive jo të pakta në të dy vendet e që do të ngronte klimën e acartë në shumë raste.

Edhe më i vakët është roli i diplomacisë së kulturës dhe asaj qytetare, i letërsisë dhe arteve, i profesorëve, historianëve, shkencëtarëve dhe sportistëve si dhe personaliteteve VIP të të dy vendeve. Këtu kemi parasysh në radhë të parë mirëkuptimin dhe krijimin e besimit të njeri-tjetri.

Në këtë drejtim kanë ndikimin e tyre të pazvendësueshëm kultura, koncertet, spektaklet, teatri dhe librat, ndeshjet dhe garat sportive, etj.

Pa mohuar disa përpjekje, gjatë

viteve të fundit shumë pak kemi parë e dëgjuar për shkëmbime grupesh dhe ansamblesh artistike, ekspozitave, galerive, vizita shkëmbimtare, aktivitete të përbashkëta, edhe pse "sebebet" nuk kanë munguar.

Dikush mund të thotë se të kërkosh gjëra të tilla në këtë mjeshtër dhe gjendje ku ndodhet dialogu politik ndërmjet dy vendeve është "luks" madje i tepruar. Mirëpo, historiku i gjatë i marrëdhënieve dypalëshe shqiptaro-greke tregon se vullneti për dialog politik nga të dyja palët është shfaqur pikërisht në momentet e krizave dhe konfliktëve. Kështu, kërcënimet nga qarqet të caktuara nacionaliste greke në vitin 1967-68 ia lanë vendin shumë shpejt demarshive që çuan në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike në vitin 1971. Ajo klimë dhe atmosferë pozitive u "çel" më tepër falë dhe një "begatie" aktiviteteve të shumta kulturore, artistike, sportive, sociale mes të dy vendeve. Kështu, në vitin 1975 erdhi në Shqipëri Marinela e famshme greke që me këngët dhe mesazhet miqësore që përcolli kudo dhe, që i shpreh dhe sot e kësaj dite, ka lënë mbresat më të mira nga ajo vizitë dhe koncertet në Shqipëri. Pas saj erdhën disa yje të tjerë të muzikës së bukur greke, pati shkëmbime ansamblesh, duke përfshirë atë të Dropullit, ekipeve sportive, shkëmbimtarë, gazetarë, etj. Të gjithë lexonim me endje mbresat dhe reflektimet miqësore për qytetërimin helen të Kadarese së madh pas vizitave në Greqi me rastet kongreshesh, etj.

Pas acarimit të këtyre marrëdhënieve në vitin 1983, sërish politika dhe diplomacia e të dy vendeve u vunë në lëvizje dhe e përmbyesën për të mirë atë situatë të ndërë, gjithnjë me mbështetjen e kulturës dhe artit. Në dhjetor 1983, në prani të autoriteteve të larta të të dy vendeve u inaugurua mes haresë, gëzimit dhe tingujve të muzikës popullore Pika Kufitare e Kakavijës. Disa vite më vonë, ministrat e jashtëm të asaj kohe, përkatësisht i ndjeri Reis Malile dhe Kostas Papulias, më vonë president i Republikës greke dolën së bashku për gueti në jug të Shqipërisë, hera e parë që praktikohet një gjë e tillë në diplomacinë tonë. Ndërsa më 1987, qeveria e Papandreu, pas presioneve të shumta të palës sonë, mori vendimin për heqjen e gjendjes së luftës; edhe pse masë gjysmake, ishte shenjë e vullnetit të mirë të palës greke. E njëjta gjë ndodhi dhe pas krizës së vitit 1993 deri te nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë në vitin 1996.

I përmendëm këto shembuj jo për nostalgji, por më shumë për të theksuar se kur këto forma pune u përdorën gjatë dekadave të kaluara kur Shqipëria ishte vend i mbyllur, deficitit në ditët e sotme është i pajustificueshëm. Sepse tashmë bëhet fjalë për dy vende aleate në NATO dhe kur Shqipëria është kandidat për në BE. Sepse ka ende rezervat që komunitetin prej qindra mijëra shqiptarë që jetojnë e banojnë në Greqi dhe minoritetin e grek në vendin tonë t'i konsolidojmë si ura të fuqishme lidhëse e jo t'i lëmë si mure ndarës.

Ja pse axhenda e larmishme e dialogut politik dhe marrëdhënieve miqësore të bashkëpunimit me Greqinë fqinje shkon përtej Kretës.

PRESIDENTI I LUFTËTARIT



Presidenti i Luftëtarit Vangjel Tavo është shfaqur tepër i revoltuar në prononcimin për mikrofonin e Supersport, menjëherë pas ndeshjes. Tavo ka kërcënuar se do ta tërheq skuadrën nga gara, pasi ndaj tyre po merrn vendime të padrejta për t'i rrëzuar nga kategoria. "Unë nuk dua të komentoj ndeshjen, sepse e panë të gjithë shqiptarët.

Kërcënon presidenti Tavo: Arbitrat bastardë, tërheq skuadrën!

Ndodhi një estradë dhe nuk është e para herë. Në qoftë se kanë marrë vendimin të na hedhin nga kategoria, e bëjmë në përpara se ta bëjnë ata. Arbitrat e tillë janë të degjeneruar. Do mblidhemi për të marrë vendimet tona. Më tha një mik në Tiranë që

ju do humbisni nesër, sepse duan të prishin garën. Nuk doja ta besoja, por ja që ndodhi. Gjyqtarët janë bastardë, i bëjë thirrje Dukës të reagojë se është dhe njeri i mençëm. Kjo është një çmenduri. Shikoni tribunat e stadiumit, janë bosh dhe

kjo vjen nga këto që ndodhin nga gjykimi. Kemi një mbledhje tani dhe do të marrim vendime: ose do të tërhiqemi nga gara, ose do ta prishim në kampionatin para se të na e bëjnë të tjerët. Janë miliona ose miliardë, që hidhen në futboll

dhe shkojnë dëm. Çfarë do të thotë të prishim kampionatin? Do luajmë me femijë të vegjël, kjo është prishje e kampionatit. Jemi njerëz të qetë dhe të butë, ndaj na e bëjnë këtë. Ata duan të fortin në fushë ose t'u japin diçka, nuk e di. Vetëm këtë sezon kemi disa raste, ku jemi masakruar, si me Kukësin dhe me Vllazninë".

Një penalti e dyshimtë dhe traversa e Kastratit vulosin humbjen e Luftëtarit



Tre gola, nga të cilët dy mes kontestimeve të Luftëtarit i dhanë fitoren Teutës në Gjirokastër, në sfidën që hapi fazën e dytë të Kategorisë Superiore. Pas triumfit 3-2 në një sfidë emocionuese, durrtsakët u kthyen te fitorja që mungonte prej afro dy muajve në kampionat. Cinike skuadra e Maganit që shfrytëzoi çdo episod për të marrë suksesin e parë pas shtatë javëve. Pretendimi i parë i vendosur u regjistrua në minutën e 22-të me Lamçjan që protestoi për penallti pas duelit me Hërkaç në zonë, por gjyqtari Ziri vazhdoi lojën. Teuta zhilloi ndeshjen pak pas gjysmë orë lojë me Amadu Latif. Sulmuesi ganez devijoi saktë me kokë një harkim perfekt nga Reza Karimi, dhe festoi me trajnerin Magani që vazhdon t'i besojë në majën e sulmit. E ndërsa Luftëtari provoi pa forcën e duhur fillimisht me Rrocën dhe më pas me Bregun, që provoi të shfrytëzonte pakujdesinë e mbrojtjes kundërshtare, Teuta ishte pranë golit të dytë me Reza Karimin, iraniani që me teknikën dhe shpejtësinë e tij ishte

"Luftë" në Gjirokastër, Teuta merr fitoren

Vendësit akuzojnë gjyqtarin Blerim Ziri

SUPERLIGA	
JAVA E 10	
TË MËRKURËN	
Luftëtari - Teuta	2-3
Vllaznia - Lushnja	E shtyrë
TË ENJTEN	
Laçi - Partizani	14:00
Kamza - Kukësi	14:00
Flamurtari-Skënderbeu	17:00



kërcënimi kryesor për gjirokastërit. Pjesa e dytë e lojës nisi me Luftëtarin në sulm dhe goli nuk vonoi. Vetëm pas 50 sekondave, Dejvi Bregu finalizoi një aksion të shkëlqyer të bluzinjve, ku shfrytëzoi asistën e Lamçjes dhe rindezi shpresat e skuadrës së tij. Gjirokastërit ishin pranë përmbysjes së madhe në të

53-ën, por shtylla i erdhi në ndihmë portierit Kastrati pas tentativës së shkëlqyer të Abazajt nga distanca. Ai episod në favor të Teutës ndryshoi rrjedhën e lojës, sepse pas një goditje dënimi të akorduar mes protestave të vendasve nga gjyqtari Ziri në gjysmefushën tjetër, Anel Dedić i dha avantazhin durrtsakëve. Në të 68-ën, u

regjistruan një tjetër vendim i kontestuar nga gjirokastërit, me gjyqtarin që akordoi 11-metërsh për Teutën, pa marrë parasysh pretendimet e vendasve. Pas protestave që zgjatën disa minuta, Dedić shënoi golin e tretë të Teutës dhe të dytën personal në ndeshje. Pas protestave jo vetëm të lojtarëve, por edhe në stol

nga trajneri Hasan Lika, Luftëtari provoi të reagoonte në fushë, duke krijuar raste të shumta me Rrocën e Aleksin, ndërsa shtylla i prishi festën e golit Bregut, pas tentativës së jashtëzakonshme nga distanca e largët. Vendësit nuk u dorëzuan deri në fund, me portierin Kastrati që pasi largoi një gol të sigurt, në sekondat e fundit të ndeshjes u thye vetëm nga autogoli i Sykajt, që ishte i pafat në devijimin e topit pas goditjes së Abazajt. Teuta largohet nga Gjirokastra me pikët e plota, ndërsa te Luftëtari ndihet të vjedhur. Këtë e konfirmuan edhe momentet pas fundit të lojës, ku arbitri Ziri qëndroi rreth 10 minuta në fushë në praninë e forcave të rendit, ndërsa dalja e tij u shoqërua me duartrokitje ironike nga lojtarët e Luftëtarit.

VENDIMET E MBLLEDHJES



Shkarkohet Ventura, ndërsa Tavekio qëndron president

Në mbledhjen e zhvilluar ditën e djeshme në Federatën Italiane të Futbollit, është marrë vendimi se trajneri Khan Piero Ventura, do të shkarkohet nga detyra e trajnerit të Kombëtares. Mbledhja që u mbajt në Romë, zgjati për më shumë se dy orë, dhe solli vendimin vetëm në orën 18:20. Ndërsa, nga ana tjetër, presidenti Karlo Tavekio, ka deklaruar se nuk do e japë dorëheqjen nga pozicioni që mban. Gjasat janë që pasuesi i Venturës në stol, të jetë Karlo Anceloti, i cili duket se është edhe i preferuar i tifozëve. Dëshimi për të kualifikuar Italinë në një Kupë Bote, pas plot 60 vitesh, shkaktoi një "tërmet" të madh në Itali.

REAGIMI I DHUNSHËM

Tifozët gjirokastëritë thejnë makinën e gjyqtarëve

Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes Luftëtari - Teuta, e cila u mbyll me fitoren e miqve 2-3, por edhe me shumë kontestime nga ana e vendasve për gjykimin, një incident ka ndodhur teksa gjyqtarët po largoheshin nga ambientet e stadiumit. "Panorama Sport" mëson se kanë qenë një grup i vogël tifozësh gjirokastëritë, të cilët i janë afruar makinës së gjyqtarëve, dhe e kanë goditur me disa mjete të forta, duke i thyer kështu xhamat dhe dritat e makinës, e duke shkakuar dëme të tjera materiale. Policia e ka pasur të vështirë të ndërhyjë, por gjyqtari kryesor Blerim Ziri dhe dy asistentët e tij kanë shpëtuar pa dëmtime. Më pas, grupi i tifozëve është larguar nga stadiumi.



Ndeshja e nesërme mes Flamurtarit dhe Skënderbeut ringjall rivalitetin e ndezur mes dy skuadrave, të cilat dikur duelonin me njëra-tjetrën për titullin kampion. Askush nuk mund ta përshkruajë më mirë se Shpëtim Duro këtë rivalitet, pasi ai ka nisur në vitet kur tekniku aktual i vlonjatëve drejtonte korçarët. "Kjo është një ndeshje mes skuadrës së vendit të parë me atë vendit të tretë. Më vjen mirë që është ky rivalitet, që ka filluar që në sezonin 2010-2011 kur kam qenë trajner i Skënderbeut. Flamurtari ka qenë shumë para me pikë, por në fund titullin e fitoi Skënderbeu. Por më shumë e ka humbur Flamurtari atë

Trajneri i Flamurtarit provokon rivalët

Duro: Qesh kur dëgjoj Skënderbeun që ankohet për mungesa




titull sesa e fitoi Skënderbeu", - kujton Duro në një prononcim për "SuperSport". Trajneri vlerëson kapitenin

e korçarëve, Orges Shehi, ndërsa e cilëson si të parëndësishëm faktin se rivalit të nesërm do t'u mungojnë disa futbollistë. "Shehi ka qenë dhe mbetet një nga figurat kryesore të këtij suksesi historik të Skënderbeut që ka ditur të menaxhojë situatat te klubi bashkë me Shkëmbin. Nëse Shehi do të largohej nga futboli, isha i bindur që Skënderbeu nuk do të kishte këtë sukses. Unë guditëm, më vjen të qesh kur shikoj të flitet për mungesa te Skënderbeu. Ajo është

skuadër që ka 22 lojtarë cilësorë në përbërje", - vijoi Duro. Ndërkq, në radhët e skuadrës së tij, emri që po spikat më shumë është sulmuesi Bushiç. Duro shprejse që lojtari të vazhdojë me këto ritme, për të ndihmuar skuadrën të rivalizojë me korçarët. "Komplimente për Bushiç, e kam vlerësuar edhe kur nuk isha trajner i Flamurtarit. Kam insistuar që të qëndroj këtu, jo vetëm për aftësitë si sulmues, por edhe se është profesionist i shkëlqyer. Skënderbeu në këtë sezon, sidomos me rezultatet e fazës së parë, ka filluar shkëputje. Unë shpresoj që të kemi një seri rezultatësh dhe një rivalitet me të jo vetëm me, por edhe Partizani me Kukësin", - tha Duro.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Hari spiune.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me diës në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.
33. Një provë zjarri.

VERTIKAL

1. Fillojnë matanë.
2. Një Hans artist dadaist.
3. Eshhtë mjet rrethoror lundrimi.
5. Eshhtë ënjite.
6. Lumi i Elizit.
7. Fillojnë mpirjen.
8. Eshhtë e gjithë Hëna.
10. Eshhtë qetësues për neurozat.
11. Taylor aktore.
12. Daniel i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mbllëngjejnë.
16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohej nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veriu pa ekstreme.
27. Janë tre në trickël.
30. Scola, regjisor italian.
31. Kufizojnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë Iloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten në skaje.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Janë lokale me kubiste.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fejuari i kukullës Barbie.
32. Rritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.
37. Eshhtë moshë e të miturit.

VERTIKAL


1. Barrymore aktore.
2. Tiriaci që që tenist.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Kaluar në krye.
7. Janë racë e pastër.
8. Një treg pa re.
10. Duhet fituar me djersë.
13. Një driturë për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregonin skllëvër dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	8		1		5			4
4					2		9	1
7	2			9	6			
		6	2	7		9		
1		5				7		2
	9	7		6	1	3		
		4	3	2			8	7
9	1		8					6
3			6		4		2	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	7	5	3	8	1	4	2	9
8	3	9	2	7	4	6	1	5
4	1	2	6	5	9	7	3	8
7	9	1	4	2	3	8	5	6
3	5	6	8	1	7	9	4	2
2	4	8	9	6	5	1	7	3
9	6	3	7	4	2	5	8	1
1	2	4	5	9	8	3	6	7
5	8	7	1	3	6	2	9	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Njerëzit e zgjuar vlerësojnë të gjithë njerëzit, pasi ata shohin të mirën në secilin dhe e dinë sa vështirë është të bësh diçka të mirë.
(Baltazar Gracian)
- Eshhtë vështirë të bëni gjëra të mëdha, por të komandoni gjëra të mëdha, është më e vështirë.
(Fridrih Niçe)
- Anija e madhe kërkon ujëra të thella.
(Xhorxh Herbert)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16		17	17	18	50	T	6A
	11	3	2	5	4	18	6	5	18	3	2
9	6	9		9	10			2	18		2
8	1		9	11	1	3	1	3	2	5	2
17		12	4	1	3	2	6	1	8	2	6
	7	4	10	3	2	6	12	3	1		14
13	6	12	5	2	3	9	4	1		11	6
	14	6	2	4	9	1		4	10	1	12
18	11		4	7		4		7	4	13	3
2	6	7			3	1	10	6		6	2
6	15	2	3	9	3		4	1	6	12	4
16	5	12	3	7	4	13	6		9	3	6

M	I	K	E	K	M	S	E			
E	K	A		R	O	M	A	K	E	T
K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A	
P	A	S	A	N	I	K	T		S	
E	K	U	A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E	E	I	R	A	N	I	
I	T	R	B	L	A	K	E		L	
M	I	A	R	E	D	E	K	I		
E			M	E	T	A	L	E	I	S
T	E	K	E		M	K	U	M	T	
M	O	R	A	V	I	A	M	A	E	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A
D	I	A	N	A	H	E	A	N	T	I	K
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S
P	E	I	T	A	R	I	F	A	L	L	E
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E
K	E	N	E	T	A	O	R	A	R		
P	A	U	L	I	N	R	A	R	I		
A	K	E	O	T	A	D	A	D	I	M	
R	E	M	U	N	E	K	I	E	R	A	
T	E	J	I	T	E	R	T	A	M	A	N
T	E	I	G	O	R	D	I	A	N	E	
I	N	T	A	R	O	M	A	D	I	T	

FJALËKRYQI (2)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O		
R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T
C	I	K	L	I	S	T	E	T			
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V	
K	A	T	I	A	S	I	E	E	S	E	
A	R	N	I	O	L	A	T				
M	A	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E
A	M	A	N	A	N	N	A	N	N		
T	T	E	R	R	E	N	T	E	T	N	E

Thënie të mëçuara

- Mendimet pa përmbajtje janë bosh, intuitat pa koncepte janë të vërbra. **Immanuel Kant Filozof (1724-1804)**
- Kur jam i lumtur, shoh lumturinë edhe tek të tjerët. Kur jam i mërzitur, vë re që sytë e njerëzve janë të trishtuar.
- Kur jam i lodhur, e shoh botën sa të mërzitshme aq edhe jo tërheqëse. **(Steve Chander)**
- Irlandeze: Ji i lumtur me çfarë ke, do të shohësh se ke përse të jesh i lumtur.
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Asgjë nuk është më e shtrëngtë, se sa ajo që blihet me lutje...!

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

